


BAHRI BECI

FLASIM DHE HARTOJMË NJOHIM GJUHËN

GJUHA SHQIPE 6

për klasën e gjashtë të shkollës fillore nëntëvjeçare

LIBRI I MËSUESIT



ENTI I TEKSTEVE DHE I MJETEVE MËSIMORE
Podgoricë, 2006

Dr. Bahri Beci

FLASIM DHE HARTOJMË

NJOHIM GJUHËN

GJUHA SHQIPE 6

për klasën e gjashtë të shkollës fillore nëntëvjeçare

LIBRI I MËSUESIT

ГОВОРИМО И САСТАВЉАМО

УПОЗНАЈЕМО ЈЕЗИК

АЛБАНСКИ ЈЕЗИК 6

за шести разред основне деветогодишње школе

ПРИРУЧНИК

Botuesi: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë

*Kryeredaktore dhe
redaktore përgjegjëse:* Natasha Zhivković

Redaktor: Zarija Brajović

Recensentë: Prof. dr. Mark Camaj
Prof. dr. Pjetër Gjuravçaj
Nazire Kurmemović, mësuese e cillit të ulit
Prof. dr. Fatmir Vadahi, pedagog
Prof. dr. Vehbi Hoti, psikolog

Ilustrimet: Simon Vučković

Disenjoja dhe faqosja: Sasha Protiq

Korrektor: Dimitrov Popović

Redaktor teknik: Rajko Radulović

Për botuesin: Nebojsa Dragović

Shtypur në

Tirazhi: 1500

ISBN: 86-303-

Këshilli i Arsimit të Përgjithshëm, me vendimin nr. të datës e ka miratuar këtë tekst mësimor për përdorim në shkollat fillore nëntëvjeçare.

PASQYRA E LËNDËS

Hyrje	4
-------------	---

KAPITULLI I PARË

Mësimi 1	Biseda telefonike	7
Mësimi 2	Anketa.....	8

KAPITULLI I DYTË

Mësimi 3	Reklama.....	10
Mësimi 4	Fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme	13
Mësimi 5	Struktura dhe familja e fjalëve	14

KAPITULLI I TRETË

Mësimi 6	Përshkrimi.....	16
Mësimi 7	Sinonimet, antonimet dhe homonimet	19
Mësimi 8	Ndryshimi i emrave	22
Mësimi 9	Ndryshimi dhe shkallët e mbiemrave	23
Mësimi 10	Numërorët.....	25

KAPITULLI I KATËRT

Mësimi 11	Struktura e tekstit	26
Mësimi 12	Përemrat vetorë	27
Mësimi 13	Përcaktori dhe ndajshtimi	29

KAPITULLI I PESTË

Mësimi 14	E vërtetë apo legjendë.....	31
Mësimi 15	Fjalja e thjeshtë dhe e përbërë	32
Mësimi 16	Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë.....	33
Mësimi 17	Llojet e fjalisë së thjeshtë	35
Mësimi 18	Kryefjala dhe kallëzuesi	36

KAPITULLI I GJASHTË

Mësimi 19	Lajmërimi.....	37
Mësimi 20	Rrethanori	39
Mësimi 21	Emërorja.....	41

KAPITULLI I SHTATË

Mësimi 22	Lajmërimi i vogël.....	42
Mësimi 23	Gjinorja.....	44
Mësimi 24	Kallëzorja.....	46
Mësimi 25	Kundrinori i drejtë.....	48

KAPITULLI I TETË

Mësimi 26	Tregimi	49
Mësimi 27	Dhanorja	50
Mësimi 28	Rrjedhorja	51
Mësimi 29	Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë.....	53
Mësimi 30	Kundrinori i drejtë me parafjalë.....	54
Mësimi 31	Gjuha zyrtare	55

Në vend të parathënies

Flasim dhe hartojmë, njohim gjuhën 6, është titulli i Kompletit të ri të tekstit mësimor të gjuhës shqipe për klasën e gjashtë dhe përfshin *Librin e nxënësit, Fletoren e punës dhe Librin e mësuesit*.

Për hartimin e tij jemi mbështetur në kërkesat e Programit të ri mësimor për mësimin e gjuhës shqipe në Mal të Zi, në arritjet e derisotme në fushën e mësimin të gjuhës shqipe, si edhe në përvojat ndërkombëtare në mësimin e gjuhëve amtare. Kompletin është i ri në përmbajtje dhe në metodë. Qëllimi i këtij kompleti të ri është që, duke respektuar Planin dhe Programin e ri mësimor, t'ua bëjë nxënësve sa më të larmishme dhe sa më tërheqëse njohuritë gramatikore-drejtshkrimore, por duke ruajtur nga tradita e deri sotme çdo gjë të dobishme dhe funksionale. Veçori e këtij kompleti është se në mësimin e gjuhës amtare, duke pasur parasysh që nxënësit në gjuhën e tyre të folur dhe të shkruar i përdorin elementet gjuhësore, fillohet me veçimin ose me zbulimin e dukurisë gjuhësore dhe, pas kësaj, kalohet në emërtimin e konceptit dhe në formulimin e përkufizimit. Pra, e veçanta e këtij kompleti është se nxënësi i zbulon, i emërton dhe i "përkufizon" vetë elementet e strukturës gjuhësore. Në këtë komplet gërshetohen njohuritë dhe shprehjet për përdorimin e gjuhës së folur dhe të shkruar me njohuritë për sistemin gjuhësor. Për këtë arsye, kërkohet të trajtohen fillimisht tema të tilla si: anketa, reklama, lajmërimi, lajmërimi i vogël, përshkrimi, tregimi etj. dhe mbi këtë bazë, përmes pyetjeve, nxiten nxënësit të dallojnë funksionet e elementeve gjuhësore. Analizat gjuhësore mbështeten pra, kryesisht në tekste jo letrare .

Tekstet jo letrare (zyrtare, shkencore, publicistike), për nga përmbajtja dhe tematika e tyre, dallohen nga tekstet letrare dhe nga gjuha e komunikimit të përditshëm. Tekstet letrare karakterizohen nga funksioni shprehës, kurse tekstet jo letrare nga funksioni njohës, megjithatë, si të parët, ashtu edhe të dytët, karakterizohen nga zbatimi e rregullave gramatikore e drejtshkrimore.

Libri i nxënësit ka tetë kapituj dhe tridhjetë e një mësim ose seanca mësimore. Në çdo kapitull, gjenden tekste jo artistike, me anën e të cilëve kërkohet të realizohet qëllimi i parashikuar në Programin mësimor (zhvillimi i të katër aftësive komunikuese: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit; si edhe zotërimi i rregullave gramatikore e drejtshkrimore).

Në kapitullin e parë trajtohen **biseda telefonike dhe anketa**. Synimi është, që nxënësit të dallojnë bisedat telefonike zyrtare dhe jozyrtare, të përgatisin vetë biseda të ngjashme dhe të marrin pjesë në to; të njohin veçoritë e anketës, të lexojnë e të raportojnë për rezultatet e anketës dhe të mësojnë të përgatisin vetë një anketë të thjeshtë.

Në kapitullin e dytë trajtohen **reklama, fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme, fjalët e thjeshta, të prejardhura dhe të përbëra, familja e fjalëve**. Synimi është, që nxënësit të zhvillojnë aftësinë e të lexuarit dhe të kuptuarit të reklamave të shtypura, të mësojnë të dallojnë reklamat e regjistruara radiofonike dhe televizive, të zhvillojnë aftësinë për të krijuar vetë reklama, duke u bazuar në atë që kanë dëgjuar, parë apo lexuar; të dallojnë fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme, që fjalë të ndryshueshme janë ato që e ndryshojnë formën e tyre gjatë përdorimit në fjali, që fjalë të pandryshueshme janë ato që nuk e ndryshojnë formën e tyre gjatë përdorimit në fjali dhe që pjesa e ndryshueshme në fund të fjalës është mbaresë; të mësojnë të dallojnë pjesët përbërëse të fjalës (rrënjën, parashtesën, prapashtesën), fjalët e thjeshta, të prejardhura dhe të përbëra, si edhe familjen e fjalës.

Në kapitullin e tretë trajtohen : **përshkrimi, sinonimet, antonimet dhe homonimet, ndryshimi i emrave, ndryshimi dhe shkallët e mbiemrave, numërorët**. Synimi është, që nxënësit të njohin veçoritë e teksteve përshkruese, t'i dallojnë ato nga reportazhet dhe të hartojnë vetë tekste përshkruese jo artistike për lojëra, valle, vegla etj., duke u mbështetur në tekstet përshkruese të analizuara në klasë.

Do të duhet të bëhet gjithashtu dallimi ndërmjet përshkrimit të bërë në tekstet artistike dhe jo artistike. Nxënësit duhet të kuptojnë që në tekstet artistike përshkrimi ka si qëllim të paraqesë peizazhet, personazhet dhe veprimet e tyre etj., kurse në tekstet jo artistike, përshkrimi ka si parësor funk-

sionin njohës (njohja e sportit, e valles, e lojës dhe historisë së tyre etj.). Për këtë, mësuesit mund të krahasojnë tekstet përshkruese jo artistike, të dhëna në *Librin e nxënësit*, me një tekst përshkrues letrar për sportin, të zgjedhur prej tyre. Synimi i këtij kapitulli është gjithashtu, që, përmes analizës së teksteve jo letrare të dallojnë sinonimet, antonimet dhe homonimet, të dallojnë rasat dhe lakimin e emrave, të dallojnë rasat dhe lakimin e mbiemrave, të dallojnë numërorët dhe disa veçori të tyre dhe t'i përdorin drejt të gjitha këto kategori gjuhësore në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Në kapitullin e katërt trajtohen: **struktura e tekstit, përemrat vektorë dhe përcaktorët**. Synimi është, që nxënësit të dallojnë strukturën bazë të një teksti, hyrjen, zhvillimin, mbylljen, si edhe ta zbatojnë atë në praktikën e analizës së teksteve dhe të hartimit të teksteve prej tyre, të mësojnë të dallojnë përemrat vektorë, lakimin dhe trajtat e shkurtra të tyre, të dallojnë përcaktorin dhe ndajshtimin dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Në kapitullin e pestë trajtohen: **legjenda, fjalja e thjeshtë dhe e përbërë, ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë, llojet e fjalisë së thjeshtë, kryefjala dhe kallëzuesi**. Synimi është, që nxënësit të kuptojnë që tekstet ndryshojnë nga njëri-tjetri, që legjendat janë tekste që paraqesin ngjarje të shkuara, të cilat janë ndryshuar e zmadhuar gjatë kohës, që fjalitë janë të thjeshta dhe të përbëra, që fjalitë e thjeshta kanë një folje, që fjalitë e përbëra kanë dy ose më shumë folje, që fjalitë e thjeshta janë dëftore, pyetëse, nxitëse dhe dëshirore, që kryefjala tregon atë për të cilin flasim dhe që kallëzuesi tregon çfarë themi për kryefjalën dhe t'i përdorin drejt ato në praktikën e gjuhës së folur dhe të shkruar.

Në kapitullin e gjashtë trajtohen: **lajmërimi, rrethanori dhe rasa emërore**. Synimi është, që nxënësit të dallojnë lajmërimet zyrtare nga ato jozyrtare, lajmërimet publike nga ato private dhe të përcaktojnë të dhënat që duhet të përmbajë një lajmërim, që rrethanori tregon rrethanën e kryerjes së një veprimi, që ka rrethanor vendi, kohe, mënyre, shkaku, qëllimi dhe sasi, që emri në rasën emërore përdoret si kryefjalë, si pjesë emërore e kallëzuesit, si ndajshtim, si thirrje dhe që t'i përdorin ato në përputhje me strukturën gramatikore të shqipes.

Në kapitullin e shtatë trajtohen: **lajmërimi i vogël, rasa gjinore, rasa kallëzore dhe kundrinori i drejtë**. Synimi është që nxënësit të dallojnë lajmërimin e vogël dhe të dhënat që duhet të përmbajë, që gjinorja përdoret si përcaktor i emrit dhe tregon përkatësi, lloj, pjesë, emërtim, pësim etj., që kallëzorja përdoret me dhe pa parafjalë dhe tregon objektin e veprimit, vend, kohë, sasi, masë etj., që kundrinori i drejtë tregon qenie ose sende mbi të cilat bie veprimi i foljes, si edhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Në kapitullin e tetë trajtohen: **tregimi, rasa dhanore, rasa rrjedhore, kundrinori i zhdrejtë pa dhe me parafjalë dhe gjuha zyrtare**. Synimi është, që nxënësit të mësojnë që tregimi paraqet ngjarje nga jeta e një personazhi, nga jeta e një familjeje ose e një populli, që tregimi ka tri pjesë themelore: hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen, që dhanorja tregon sendin a personin të cilit i drejtohet veprimi, që përjeton diçka ose që i përket diçka, që rrjedhorja përdoret si përcaktor i një emri dhe si rrethanor vendi, kohe, shkaku etj., që kundrinori zhdrejtë pa parafjalë është në rasën dhanore, që kundrinori i zhdrejtë me parafjalë ndërtohet me emra, përemra të paraprirë gjithmonë nga një parafjalë. Në këtë kapitull do të mësohet gjithashtu, që të dallohen konceptet gjuhë zyrtare dhe gjuhë jozyrtare dhe të përcaktohen gjuha zyrtare dhe gjuha në përdorim zyrtar në Mal të Zi, si edhe shtrirja e përdorimi i tyre, do të mësojnë gjithashtu që gjuha letrare shqipe është gjuha e përdorur në libra, gazeta, revista, në radio, televizion, në shkencë, art, politikë etj., që gjuha shqipe ka dy dialekte: gegërishten (dialektin e Veriut) dhe toskërishten (dialektin e Jugut).

Në *Tekstin mësimor* janë parashikuar për punë tri projekte, në të cilët nxënësit duhet të zbatojnë gjithçka që kanë mësuar brenda një kapitulli dhe të krijojnë diçka të re (anketa, reklama, fjalori i klasës i sinonimeve, homonimeve dhe antonimeve).

Teksti synon që, përmes teksteve, CD^{sc}, fotografive, ilustrimeve e diagrameve, ta çlirojë mësimin e gramatikës prej shablloneve dhe ta bëjë atë zbavitës, por jo më pak serioz dhe shkençor, të tregojë se rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore nuk duhet të jenë të mërzitshme dhe të thata, por të zbatueshme në shumë fusha.

Ilustrimet në *Testin mësimor* kanë edhe karakter zbavitës, janë funksionale dhe shërbejnë drejtpërdrejt për ngulitjen e njohurive.

Fletorja e punës ka të njëjtit kapituj dhe mësim si *Teksti mësimor*, sepse është parashikuar të përdoret krahas *Tekstit mësimor*. Kërkesat dhe detyrat janë në përputhje me standardet e njohurive, respektivisht me kërkesat minimale dhe mesatare të kërkesave të provimit. Në çdo kapitull, synohet që të kalohet nga detyrat e lehta tek më të vështirat. Në disa detyra, në fillim, është dhënë zgjidhja si shembull sesi duhet punuar, kështu që nxënës-i/ja di se çfarë kërkohet prej tij/saj. Nuk është e thënë që të gjithë nxënësit duhet patjetër t'i zgjidhin saktë të gjitha detyrat (kjo varet nga interesimi dhe nga aftësia e tyre). Në *Fletoren e punës* gjenden tri teste, me të cilat bëhet përsëritja dhe kontrollimi i lëndës së mësuar (pas punimit të dy-tre kapitujve), ndërsa në fund fare është testi me të cilin sistemohet e gjithë lënda mësimore që është mësuar në Lëndën e gjuhës amtare në klasën VI. Me këto teste, nxënësit përgatiten për zgjidhjen e testeve që do të hartojë dhe do të përdorë mësues-i/ja për vlerësimin përfundimtar të njohurive të tyre.

Në *Tekstin mësimor nuk* ka detyra shtëpie. Ato nuk janë harruar, por është bërë përpjekja që t'i jepet përparësi punës në shkollë (përveç se kur është fjala për punë kërkimore, e cila, nëse ka kushte, mund të organizohet edhe në shkollë). Natyrisht, mësues-i/ja mund t'i japë detyrat e shtëpisë dhe, bile, ato që janë si ushtrime në *Fletoren e punës*.

Gjithçka që nxënësit duhet të shkruajnë në *Fletore ne punës* është shkruar në *Librin e mësuesit*. Kjo nuk do të thotë, se mësues-i/ja nuk mund të kapërcejë, të plotësojë, d.m.th. të ndryshojë diçka, por për këtë duhet të ketë parasysh standardet e njohurive dhe kërkesat e provimit që ndodhen në Programin mësimor.

Ka disa probleme të diskutueshme në fushën e analizës gramatikore, sidomos për kallëzuesin që disa e identifikojnë me foljen, kurse të tjerë me grupin foljor si tërësi. *Teksti* në këtë pikë merr parasysh Programin, i cili dallon kallëzuesin foljor dhe emëror si dy kategori më vete.

Çdo mësim e kemi ndarë në orë mësimore. Kjo ndarje në orë për zhvillimin e lëndës së re dhe për kontroll, si dhe numri i orëve brenda një kapitulli, nuk është se janë të detyrueshme për mësuesit, por është e këshillueshme që të arrihet qëllimi në përputhje me standardet e njohurive dhe me kërkesat e provimit. Mësues-i/ja duhet të ketë parasysh gjithashtu edhe numrin e orëve të caktuara për hartimet (një hartim në semestrin e parë dhe dy hartime në semestrin e dytë).

Për mësimin e gjuhës, në klasën VI, janë parashikuar 90 orë (60 %), ndërsa për mësimin e letërsisë 60 orë (40 %). 20 % e orëve të mësimin (10 % për mësimin e Gjuhës dhe 10 % për mësimin e Letërsisë) janë lënë në dispozicion të mësuesit që t'i përzgjedhë e caktojë ai vetë.

Rekomandohet që 35 orë mësimi t'i kushtohen zhvillimit të lëndës së re dhe 28 orë mësimi kontrollit, ushtrimeve dhe zgjidhjes së testeve.

Mësues-i/ja mund të përdorë në orën e mësimin edhe tekste të regjistruara prej tij në CD. Ato do t'i aftësojnë nxënësit për të dëgjuar, si edhe për të veçuar faktet e rëndësishme nga ato të parëndësishme.

Mirëpresim të gjitha vërejtjet e sugjerimet për botimin e dytë, veçanërisht nga ata që do të kenë rastin ta vlerësojnë këtë Komplet teksti mësimor në punën e tyre të drejtpërdrejtë me nxënësit.

Autori

Bisedat telefonike

Synimi: të dallojnë nxënësit bisedat telefonike zyrtare dhe jozyrtare, të përgatisin vetë biseda të ngjashme dhe të marrin pjesë në to.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- zhvillon me nxënësit një bisedë të lirë për veçoritë e komunikimit me telefon, për mënyrën e të folurit, për rolin që lozin toni i zërit, shikimi, shprehja e fytyrës, gjestet etj.;
- u thotë nxënësve se do të mësojnë diçka më shumë lidhur me bisedat telefonike dhe i fton që të vështrojnë fq. 6 të *Librit të nxënësit*;
- bën pyetjet e parashtruara, fq. 6 e *Librit të nxënësit* lidhur me dy bisedat telefonike: Kush flet? Me kë flet? Për çfarë flet? A vini re dallime në mënyrën e të folurit? Përse ndryshon mënyra e të folurit? Bisedat, në fjalë a janë zyrtare apo jozyrtare? Nga e kuptoni?;
- nxjerrin përfundimet që biseda telefonike mund të jetë: *zyrtare, jozyrtare, privat, pune*; që kur bie telefoni fiks, ai të cilin e thërrasin, thotë i pari: "alo", "urdhëroni", "po", "ju lutem"...; që ai, i cili thërret, mund të prezantohet dhe të thotë mbiemrin e familjes që kërkon ose e kundërta të thotë mbiemrin e familjes etj.;
- u kërkon të përgatisin në çifte nga një bisedë telefonike; cakton se cili çift do të përgatisë një bisedë zyrtare dhe cili një bisedë jozyrtare;
- brenda 10-15 minutash, nxënësit përgatisin bisedën dhe e paraqitin atë para klasës;
- mund të vijojë diskutimi për bisedat e përgatitura telefonike (përcaktohen bashkëbiseduesit, kultura e të folurit, intonacioni etj.).

Ora e dytë

Synimi: të përforcojnë dhe të verifikojnë nxënësit shkallën e përvetësimit të njohurive përmes-ushtrimeve verifikuese, zbatuese dhe krijuese; është etapa e fundit, po jo më pak e rëndësishmja. Aktivizimi i një numri sa më të madh nxënësish në të gjitha etapat e mësimit, po në mënyrë të veçantë në këtë etapë, ndikon drejtpërsëdrejti në shkallën e përvetësimit të njohurive dhe në qëndrueshmërinë e tyre.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon nxënësve të lexojnë ose, në qoftë se mund ta kenë regjistruar, ta dëgjojnë me kujdes tekstin e bisedës telefonike në Fletoren e punës (fq. 4);
- bën pyetjet : Kush janë bashkëbiseduesit? Për se bisedojnë? Cili është raporti midis dy bashkëbiseduesve? Si prezantohet në telefon sekretarja e ministrisë? Si i përgjigjet sekretarja e drejtorit të shkollës? U kërkon të shpjegojnë kulturën e të folurit të bashkëbiseduesve dhe të thonë nëse është bisedë zyrtare apo jozyrtare?;
- kërkon nga nxënësit të zgjidhin ushtrimet 1., A, B në *Fletoren e punës*. Tregon kujdes që të përforcohen njohuritë e fituara në orën e parë të mësimit.

Vërejtjet e mësuesit:

Anketa

Synimi: të njohin nxënësit veçoritë e anketës, të lexojnë e të raportojnë për rezultatet e anketës dhe të mësojnë të përgatisin vetë një anketë të thjeshtë.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të thonë nëse dinë diçka se çfarë është anketa, nëse kanë pasur rastin të shohin a të marrin pjesë në një anketim, nëse dinë se përse dhe si bëhet një anketë;
- u thotë nxënësve se do të mësojnë diçka më shumë për qëllimet dhe mënyrën e ndërimit dhe të nxjerrjes së përfundimeve të një ankete;
- i fton nxënësit që të lexojnë anketën në fq. 8 të *Librit të nxënësit*;
- bën pyetje: Cili është synimi ose objekti i anketës? Çfarë të dhënash kërkohen? Çfarë lloj pyetjesh janë bërë në këtë anketë? Si janë gërshetuar pyetjet?;
- nxjerr përfundimet që për përgatitjen e një ankete fillimisht duhet përcaktuar synimi ose objekti i anketës, kujt i drejtohet, të dhënat a informacionet që duhet të përmbajë anketa, lloji i pyetjeve që duhen bërë etj.

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- në bashkëpunim me nxënësit shqyrtojnë metodën e zbatuar për nxjerrjen e rezultateve. I pyet nxënësit: Sa forma të paraqitjes së rezultateve vini re? Cila ju duket më e qartë? Pastaj u kërkon ta argumentojnë mendimin e tyre;
- nxjerrin përfundimet që paraqitja e rezultateve të anketës mund të bëhet: *me tekst, me tabela ose grafikë*;
- bëjnë vlerësimin e tyre duke lënë të kuptohet se mënyra e nxjerrjes së rezultateve të tyre ndryshon në vartësi nga lloji i anketës dhe mënyrës që zgjedh autori i saj për të nxjerrë rezultatet. Kuptojnë që anketa jep rezultate numerike në vartësi të kërkesave të bëra dhe synimit të anketës.

Ora e tretë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- i ndan nxënësit në 5 ose 6 grupe dhe u kërkon që çdo grup, në bazë të fotografive në fq. 14-15 të *Librit të nxënësit*, të përcaktojnë temën e anketës. Pastaj u kërkon të përgatitin pyetjet për fletanketën. Pyetjet duhet të jenë të qarta dhe të sakta, të drejta nga ana gramatikore dhe drejtshkrimore;
- cakton si kohë pune në grup 20 minuta. Pastaj kërkon që çdo grup të paraqes brenda dhjetë minutave fletanketën e vet (përfaqësuesi i çdo grupi informon rreth 2 minuta), pastaj çdo grup zgjedh (por jo të vetën) fletanketën me temën më interesante (rreth 5 minuta);
- pasi është zgjedhur fletanketa e përgatitur më mirë, mësues-i/ja, dhjetë minutat e fundit, nëse është e nevojshme, organizon korrigjimin dhe riformulimin e pyetjeve me pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve;
- fletanketa e përgatitur mbetet tek mësues-i/ja, e cila përgatit numrin e mjaftueshëm të fletëve për anketimin e nxënësve.

Materialet që do të përdoren: fletanketat e plotësuara nga nxënësit e klasës, fletët për ndërtimin e tabelave e të diagrameve.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- mësues-i/ja i ka fotokopjuar fletanketat për pesë grupe. U jep nxënësve fletanketat e plotësuara nga nxënësit (çdo grup merr aq fletanketa të plotësuara sa nxënës janë anketuar);
- në varësi nga marrëveshja (ose nga vendimi i mësues-it/es), çdo grup mund t'i shqyrtojë të pesë pyetjet e anketës ose nga një pyetje (gjë që është më mirë për shkak të kohës që duhet për shqyrtimin e të dhënave). Koha për punën në grupe është 25 minuta.
- i ndihmon nxënësit të merren vesh brenda grupit për ndarjen e detyrave (kush do t'i përpunojë me shkrim të dhënat, kush do t'i shënojë të dhënat në tabelë dhe në diagram);
- përfaqësuesi i çdo grupi raporton të dhënat e shqyrtuara (listat me tabelat dhe diagramet vendosen në dosje) Koha për raportim është 15 minuta (çdo grup ka 2,5-3 minuta kohë);
- pesë minutat e fundit, mësues-i/ja tregon të dhënat tek të cilat ka arritur gjatë shqyrtimit të pyetjeve të anketave dhe i krahason ato me të dhënat e nxënësve, duke treguar gabimet e mundshme.

Vërejtjet e mësuesit:

Reklama

Synimi: të zhvillojnë nxënësit aftësinë e të lexuarit dhe të kuptuarit të reklamave të shtypit, të mësojnë të dallojnë reklamat e regjistruara radiofonike dhe televizive, të krijojnë vetë reklama, duke u bazuar në atë që kanë dëgjuar, parë apo lexuar.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u tregon nxënësve reklama në qese, në veshje, në shtypin e përditshëm etj. dhe bën pyetjet: Si do ta emërtonit mbishkrimin në qese, bluzë etj.? Në cilat medie është e pranishme reklama? Ku dallohen reklamat e shtypit nga ato në televizor ose në radio?;

- i fton nxënësit që të vështrojnë tekstin në fq. 18-19 të *Librit të nxënësit*;

- bën pyetje: Çfarë është ky tekst? Kush e ka porositur atë? Cili është qëllimi i porositësit të tij? Çfarë është theksuar në veçanti në tekst? Me se është realizuar ky theksim? Çfarë është shkruar me shkronja të vogla? A të bën kjo reklamë të mendosh për të blerë dhe lexuar libra? Dhe u kërkon ta shpjegojnë përgjigjen;

- vijon diskutimin për grupin e reklamave që vinë pas. Bën pyetjet: Çfarë janë tekstet e mësipërme? Çfarë reklamohet në to? Kujt i kushtohen këto reklama? Çfarë të tërheq vëmendjen tek reklama e cigareve? Cila reklamë të pëlqen më shumë? Pse? A ju nxitin reklamat për të blerë? Çfarë dallimi ka ndërmjet reklamave radiofonike, televizive dhe të shtypit?;

- në vijim të diskutimeve nxjerrin përfundimet që reklama është rekomandim, theksim i karakteristikave të mira të mallit, prodhimit, shërbimeve, vënia në dukje e cilësisë, e çmimit të arsyeshëm, e kushteve të veçanta të furnizimit etj., që qëllimi i reklamës është të tërheqë vëmendjen e blerësve dhe të konsumatorëve për blerjen e një malli a prodhimi të caktuar, që ekzistojnë reklama të shtypura radiofonike, televizive dhe e shtypshkruar, që reklamat qëllimin e arrijnë me efektet zanore e vizuale, si dhe me përdorimin specifik të gjuhës, që reklamat televizive shihen më shumë se sa dëgjohet radioja ose lexohet shtypi, që, në dallim nga reklamat televizive, reklamat e shtypit mund të lexohen disa herë, kështu që blerësi ka mundësi ta analizojë problemin, për të cilën bën fjalë reklama (pra të përcaktojë kush është porositësi i reklamës, çfarë reklamohet, kujt i kushtohet ...).

Ora e dytë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u thotë nxënësve të dëgjojnë me vëmendje reklamat radiofonike (mundësisht të regjistruara në CD^e).

1. Reklama për « Shkollën e mesme artistike »:

Doni të bëheni artist, piktor, skulptor, këngëtar, muzikant; konkurroni për shkollën e mesme të muzikës në Podgoricë. Të gjitha të dhënat e nevojshme do t'i gjeni në sitin e internetit www.shartstike.org. Mund të na kontaktoni edhe me telefon në numrin 069 * **.**

Shkolla e mesme artistike Podgoricë, rruga me e sigurt për t'u bërë artist

2. Reklama për « _____ »

Reklamë për ulje çmimesh 50% ulje

3. Reklama për “_____”

4. Reklama për “_____”:

- pyet: Çfarë reklamohet në reklamën e parë? Po në të tjerat? Kujt i kushtohet reklama e parë? Kush e ka porositur atë? Në ç’reklama përmendet ulja e çmimeve dhe çmimet “tërheqëse”? Kush është porositësi i këtyre reklamave? Kush është porositësi i reklamës së katërt? Çfarë ndryshon në reklamën e katërt në krahasim me të mëparshmet? Si quhen reklamat që i dëgjojmë në radio?;

- kërkon që t’i dëgjojnë edhe një herë reklamat dhe t’i kushtojnë vëmendje përdorimit të gjuhës, rregullsisë gramatikore dhe efekteve zanore të reklamave dhe të përpiqen t’i mbajnë mend sa më mirë;

- pas dëgjimit të dytë i pyet: Cila reklamë ju ka pëlqyer më shumë? Pse? Cilën keni mbajtur mend më mirë dhe më lehtë? Çfarë ka ndikuar në mbajtjen mend lehtë të asaj reklame? U kërkon të krahasojnë reklamën e parë dhe të katërt. I pyet: Cilën e konsideroni më të suksesshme? Dhe u kërkon të shpjegojnë përgjigjen;

- nxënësit konstatojnë se gjuha e reklamave, në raport me përdorimin e gjuhës në të folurit e përditshëm, në shtyp dhe në shkollë, është plot lëvdata, është mbresëlënëse dhe pozitive. Kërkon argumentimin e këtij mendimi me të dhëna nga reklamat e dëgjuara.

Ora e tretë

Synimi: të projektojnë dhe zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për reklamat.

Materialet që do të përdoren: fletë vizatimi, bojëra, tempera (akuarel) dhe stenda.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- i ndan nxënësit në 5 ose 6 grupe dhe çdo grup ka detyrë të bëjë një reklamë shtypi, të cilën pastaj do ta shndërrojë në reklamë radiofonike ose televizive. Grupi i parë mund t’i bëjë reklamë një lloj qumështi, kosi, lëngu frutash dhe të tregojë risitë. Grupi i dytë mund të bëjë një reklamë për një libër, revistë, fjalor të një gjuhe të huaj (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, rusisht etj.) dhe të theksojë se ky është botim i ri, i plotësuar, duke pasur parasysh numrin e fjalëve. Grupi i tretë mund të bëjë një reklamë për një restorant, piceri, një hotel (rëndësi ka adresa). Grupi i katërt mund të bëjë një reklamë për një dyqan (uljet e çmimit) dhe të tregojë mundësitë e ndryshme të pagesës (pagesë me para në dorë, kreditë ...). Grupi i pestë mund të bëjë një reklamë për pajisje shtëpiake, mobilieri, prodhime elektronike dhe të theksojë uljen e çmimeve ;


- cakton si kohë pune 20 minuta për çdo grup. Pastaj kërkon që brenda 5-6 minutave grupet të paraqesin reklamat e veta radiofonike (vetëm me fjalë) ose televizive (ka rëndësi edhe paraqitja skenike). Përfaqësuesi i çdo grupi ka në dispozicion 1 minutë për të paraqitur reklamën;

- mësues-i/ja vendos në stendë reklamat e çdo grupi. Grupet kanë pastaj për detyrë që, në çdo reklamë (përveç reklamës së grupit të vet) të dallojnë: Kush është porositësi i reklamës? Cili është malli që reklamohet? Cili është qëllimi i reklamës? Si janë përshtatur efektet vizuale me përdorimin e gjuhës?;

- kërkon që çdo grup të zgjedhë reklamën më bindëse e më origjinale (veçmas atë të shtypit, radiofonike dhe televizive) dhe të argumentojë përzgjedhjen e vet (koha për punë është 5 minuta); përfaqësuesi i çdo grupi raporton për konkluzionet e arritura nga çdo grup (koha e raportimit të çdo përfaqësuesi është 2–3 minuta); në fund, zgjidhet reklama e bërë më mirë.

Vërejtje: Mësues-i/ja, nëse e sheh të nevojshme, mund të përdorë edhe një orë tjetër mësimi për reklamën. Ndarja e këtij kapitulli dhe e kapitujve të tjerë në orë mësimi, nuk është e detyrueshme për mësues-in/en.

Vërejtjet e mësuesit:



Fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë nxënësit që fjalët mund të jenë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme, që fjalë të ndryshueshme janë ato që e ndryshojnë formën e tyre gjatë përdorimit në fjali, që fjalë të pandryshueshme janë ato që nuk e ndryshojnë formën e tyre gjatë përdorimit në fjali dhe që pjesa e ndryshueshme në fund të fjalës është mbaresë.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- i fton nxënësit që të lexojnë reklamën në fq. 22 të *Librit të nxënësit* dhe u kërkon të formojnë fjali me fjalët *javë, libër, fëmijë, cirk, për, me*;

- bën pyetje: A ndryshojnë formë gjatë përdorimit në fjali emrat *javë, libër, fëmijë, cirk*? Çfarë fjalësh janë emrat *javë, libër, fëmijë, cirk* që ndryshojnë gjatë përdorimit në fjali? A ndryshojnë formë gjatë përdorimit në fjali fjalët *për, me*? Çfarë fjalësh janë parafjalët *për, me* që nuk ndryshojnë gjatë përdorimit në fjali?;

- nxjerr përfundimet që emrat *javë, libër, fëmijë, cirk, gjatë* përdorimit në fjali ndryshojnë formë, që emrat janë fjalë të ndryshueshme, që parafjalët *për, me* nuk ndryshojnë formë gjatë përdorimit në fjali, që parafjalët janë fjalë të pandryshueshme;

- kërkon që nxënësit të përcaktojnë kategorinë gramatikore të mbiemrave dhe ndajfoljeve në tabelën përkatëse (*i shpejtë, e shpejtë, të shpejtë/shpejt*) dhe të thonë nëse janë fjalë të ndryshueshme ose të pandryshueshme;

- nxjerr përfundimin që mbiemrat janë fjalë të ndryshueshme, kurse ndajfoljet fjalë të pandryshueshme;

- kërkon të vëzhgojnë tabelat me kategoritë gramatikore të fjalëve të ndryshueshme e të pandryshueshme;

- bën pyetjet: Çfarë janë fjalët me shkronja kursive? Cilat pjesë të ligjëratës ndryshojnë gjatë përdorimit në fjali? Cilat janë pjesët e ligjëratës që nuk ndryshojnë gjatë përdorimit në fjali? Nuk është e detyrueshme që mësues-i/ja të këmbëngulë në dallimin dhe në emërtimin e llojeve të pandryshueshme të fjalëve (lëndë e klasës VII). Nxënësit duhet të përqendrohen në dallimin midis fjalëve të ndryshueshme e të pandryshueshme;

- kërkon që nxënësit të vështronë emrin *lis-i* në tabelën përkatëse dhe bën pyetjet : A ka ndryshuar formë emri *lisi*? Cila pjesë e fjalës ka mbetur e njëjtë? Si quhet ajo? Cila pjesë e fjalës ka ndryshuar? Si quhet ajo? A ka ndryshuar kuptimi i fjalës?;

- nxjerr përfundimin që pjesa e ndryshueshme në fund të fjalës quhet *mbaresë*.

Ora e dytë: verifikim e përforcim i njohurive

Mjeti që do të përdoret: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-5, fq. 8-9.

Vërejtjet e mësuesit:

Struktura dhe familja e fjalës

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit pjesët përbërëse të fjalës (rrënjën, parashtesën, prapashtesën), fjalët e thjeshta, të prejardhura dhe të përbëra, si edhe familjen e fjalës.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- i fton nxënësit që të lexojnë pjesën e shkëputur nga teksti *Historia e reklamave* fq. 24 dhe të vështrijnë ndërtimin e fjalëve me shkronja blu;

- bën pyetje: A mund të heqim diçka nga fjalët *reklamë, shumë, mjaft* dhe të na dalë një fjalë e re? Çfarë fjalësh janë ato? Çfarë fjale ka në bazë fjala *shpërndaj*? Si quhet ajo? Çfarë është shtuar dhe ku? Si quhet pjesa e shtuar? Cila është rrënja e fjalës *reklamim*? Çfarë është shtuar dhe ku? Si quhet pjesa e shtuar? Si janë formuar fjalët *dorëshkrim, dora-dorës*?;

- nxjerrin përfundimet që nga fjalët *reklamë, shumë, mjaft* nuk mund të heqim asgjë, që ato janë fjalë të thjeshta, që fjala *shpërndaj* ka në bazë fjalën *ndaj*, që është shtuar përpara *shpër-*, që *shpër* është parafjalë, që rrënja e fjalës *reklamim* është *reklamë*, që është shtuar pas *-im*, që *-im* është prapashtesë dhe që fjalët *dorëshkrim, dora-dorës* janë formuar nga bashkimi i dy fjalëve;

- kërkon që nxënësit të vështrijnë pasqyrën ku jepen fjalët e prejardhura *punoj, punim, punëtor, punësoj, përpunoj* dhe bën pyetjet: Si quhet pjesa e fjalës që nuk ndryshon? Cila është rrënja e fjalëve: *punoj, punim, punëtor, punësoj, përpunoj*? Cilat ndajshitesa i janë shtuar rrënjës së fjalës? Si quhen fjalët e krijuara me ndajshitesa të ndryshme nga e njëjta rrënjë?;

- nxjerr përfundimin që pjesa e kuptimshme e fjalës që mbetet, në qoftë se heqim pjesë të ndryshme të saj (*punoj, punim, punëtor, punësoj, përpunoj*), është rrënja e fjalës, që fjalët e formuara me ndajshitesa janë fjalë të prejardhura;

- kërkon që nxënësit të vështrijnë pasqyrën ku jepen fjalët e përbëra *punëdhënës, punëzi* dhe bën pyetjet: Si janë formuar fjalët *punëdhënës, punëzi*? Ku dallohen fjalët *punëdhënës, punëzi* nga fjalët *punim, punëtor*?;

- nxjerr përfundimin që fjalët *punëdhënës, punëzi* janë formuar nga bashkimi i dy fjalëve dhe që fjalët e formuara nga bashkimi i dy fjalëve janë fjalë të përbëra;

- kërkon që nxënësit të vështrijnë pasqyrën, ku jepet familja e fjalës *i bukur* dhe bën pyetjet: Si janë formuar fjalët *bukurosh, bukuri, zbukuroj*? Po fjalët *zbukuruar, zbukurim, zbukurues* si janë formuar? Si quhet bashkësia e fjalëve të formuara nga e njëjta fjalë rrënjë?;

- nxjerr përfundimin që bashkësia e fjalëve të prejardhura e të përbëra të ndërtuara mbi të njëjtën fjalë rrënjë (*i bukur, bukurosh... ose vesh, veshje, i veshur, veshmbathje* etj) quhet *familje fjalësh*.

Ora e dytë: verifikim e përforcim i njohurive

Mjeti që do të përdoret: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte a në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-13, fq. 10, 11, 12.

Vërejtje: Mësues-i/ja, nëse e sheh të nevojshme, mund të përdorë edhe një orë tjetër mësimi për këtë temë. Ndarja e mësimëve në orë mësimi, nuk është detyrueshme për mësues-in/en.

Vërejtjet e mësuësit:

Përshkrimi

Synimi: të njohin nxënësit veçoritë e tekstit përshkrues dhe të ndërtojnë vetë tekste përshkruese jo artistike për lojëra, valle, vegla etj., duke u mbështetur në tekstet përshkruese të analizuara në klasë.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon nxënësve të thonë disa emra lodrash sportive, i pyet se cila u pëlqen më shumë dhe pse, çfarë mund të thonë për futbollin (fusha, numri i lojtarëve, qëllimi i lojës, si quhen dy pjesët e lojës dhe sa zgjat secila, lojtarët dhe klubet që njohin etj;
- i fton nxënësit që të lexojnë tekstin për futbollin në fq. 28 të *Librit të nxënësit*;
- bën pyetje: Për se flitet në këtë tekst? A paraqiten ngjarje? A shënohet koha dhe vendi në këtë tekst? A mund të bësh pyetje të tilla si *kush?*, *çfarë?*, *ku?*, *kur?*, *si? përse?* Cilat të dhëna nga teksti janë të domosdoshme për përshkrimin e futbollit si lojë? Teksti për futbollin, a është një *përshkrim?* dhe u kërkon ta argumentojnë përgjigjen;
- kërkon ta lexojnë edhe një herë tekstin për futbollin;
- bën pyetje: Ku zhvillohet loja e futbollit? Çfarë përmasash ka fusha e futbollit? Cili është numri i lojtarëve dhe si quhen ata? Kush quhen mbrojtës, mesfushorë dhe sulmues? Cili është synimi i lojtarëve në lojën e futbollit? Cilat janë rregullat e lojës?;
- gjatë diskutimeve nxjerrin përfundimet që teksti për futbollin është një përshkrim, që përshkrimi paraqet pamjen ose tiparet e dikujt a të diçkaje, rrethanat e zhvillimit të një ngjarjeje, që përshkrimin nuk kanë rëndësi koha e ngjarjes dhe rrjedha e tyre (mund të përshkruhet, p.sh., jeta në Romën e Vjetër apo në Greqinë antike), si edhe përgjigjet ndaj pyetjeve *kush?*, *çfarë?*, *ku?*, *kur?*, *si?*;
- u kërkon të lexojnë tekstin për historinë e futbollit dhe të diskutojnë e përcaktojnë elementet kryesore që lidhen me këtë tekst.

Ora e dytë

Synimi: të njohin nxënësit veçoritë e reportazhit në përfaqje me tekstin përshkrues dhe të përforcojnë njohuritë për tekstin përshkrues.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të flasin për aktualitetet e futbollit në Mal të Zi dhe për ndeshjet e zhvilluara kombëtare e ndërkombëtare kohët e fundit. Mund të vështrojnë ndonjë reportazh sportiv në ndonjë prej gazetave sportive ose jo;
- fton nxënësit që të lexojnë tekstin “*Sevilja*” fiton kupën UEFA, në fq. 29 të *Librit të nxënësit*;
- bën pyetje: Për se bëhet fjalë në këtë tekst? A paraqiten ngjarje në këtë tekst? A shënohet koha dhe vendi? Cilat fjalë tregojnë kohën e zhvillimit të ngjarjes? Cilat fjalë tregojnë vendin e zhvillimit të ngjarjes? A mund të bësh pyetje të tilla si *kush?*, *çfarë?*, *ku?*, *kur?*, *si? përse?*;
- u thotë nxënësve se teksti për futbollin ishte një përshkrim, kurse teksti “*Sevilja*” fiton kupën UEFA është një reportazh dhe u kërkon të thonë se cilat janë dallimet ndërmjet këtyre dy teksteve;
- në vijim të diskutimeve nxjerr përfundimet: reportazhi është një ose disa artikuj të shkruar nga gazetarë, që mbështeten në të dhëna të mbledhura në vendin e ngjarjes, që

reportazhi paraqet ngjarje nga jeta e përditshme, që hartuesi i tij i ka parë vetë, që për reportazhin ka rëndësi koha, vendi dhe shtjellimi i ngjarjeve, që reportazhi u përgjigjet pyetjeve *kush?, çfarë?, ku?, kur?, si? (përse?)* etj. dhe se dallohet nga përshkrimi.

Ora e tretë

Synimi: të njohin nxënësit veçoritë e përshkrimit të një valleje dhe të përforcojnë njohuritë për tekstin përshkrues.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të flasim për vallet në përgjithësi dhe vallet shqiptare në Mal të Zi, si edhe për dallimet e tyre nga vallet e malazezve dhe arsyet e këtyre dallimeve;

- i fton nxënësit që të lexojnë tekstin “*Tangoja*” në fq. 30 të *Librit të nxënësit*;

- bën pyetje: Për se flitet në këtë tekst? A paraqiten ngjarje në këtë tekst? A shënohet koha dhe vendi? A mund të bësh pyetjet të tilla si *kush?, çfarë?, ku?, kur?, si? përse?* Çfarë është ky tekst, reportazh apo përshkrim;

- në vijim të diskutimeve nxjerr përfundimet se teksti *Tangoja* është një përshkrim i një valleje, se aty nuk paraqiten ngjarje nga jeta e përditshme, po jepen të dhëna për historinë dhe përshkruhet si kërcehet tangoja;

- kërkon ta lexojnë edhe një herë tekstin për tangon;

- bën pyetje: Nga e ka origjinën tangoja? Kush e përhapi nga Argjentina në Evropë? Në ç’qytet u ndryshua për herë të parë tangoja për sallat e vallëzimit? Kush i bëri ndryshimet përfundimtare të lëvizjeve të këtij vallëzimi? Si kërcehet tangoja?;

- gjatë diskutimeve nxjerr përfundimet: që tangoja e ka origjinën nga Afrika, që prej andej ka kaluar në Argjentinë, se kanë qenë marinarët që e kanë sjellë tangon në Evropë, që më 1910 ajo ka depërtuar në sallat e vallëzimit të Parisit, që pas luftës së Parë Botërore, tangoja mori një pamje krejtësisht tjetër dhe u bë e përshtatshme për të gjithë nga Viktor Silvestri në Londër, që gjatë vallëzimit çifti bën një hap në njërin anë dhe dy hapa në anën tjetër;

- u kërkon të shohin figurën në fq. ... të *Librit të nxënësit*, ku jepet një aspekt nga një ndeshje volejboli;

- bën pyetje: Si quhet kjo lojë? Ku luhet? Çfarë dini për numrin e lojtarëve? Çfarë dini për rregullat e lojës?, u kërkon që duke pasur parasysh lojën e futbollit dhe tangon të përshkruajnë lojën e volejbollit. Për t’u ardhur në ndihmë nxënësve në tekstin e nxënësit është dhënë një skicë e fushës së volejbollit me përmasat e saj dhe përmasat e rrjetës së volejbollit;

- nxjerr përfundimin, se për të përshkruar një sport, vallëzim (valle) apo lojë shoqërore, duhet të përmenden të dhënat historike, veçoritë e lojës, mjete, qëllimi i lojës, numri i lojtarëve, emërtimi i pjesës së lojës apo të ndeshjes. Disa prej këtyre të dhënave mund të mos shënohen për shkak të veçorive të temës për të cilën flitet apo shkruhet, për shembull tek vallëzimi mungojnë mjetet dhe emërtimi i pjesës së vallëzimit, tek shahu emërtimi i pjesës së lojës.

Ora e katërt

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për përshkrimin.

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- Kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e

18 ushtrimeve 1-7, fq. 13, 14, 15. Gjatë 15-20 minutave bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtje: Mësues-i/ja, nëse e sheh të nevojshme, mund të përdorë edhe një orë tjetër mësimi për këtë temë. Ndarja e mësimeve në orë mësimi, nuk është detyrueshme për mësues-in/en.

Vërejtjet e mësuesit:

Sinonimet, antonimet dhe homonimet

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë nxënësit të dallojnë sinonimet, antonimet dhe homonimet dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të thonë se çfarë dinë për Kampionatin Botëror të Futbollit dhe veçanërisht për atë të Gjermanisë në vitin 2006;

- i fton nxënësit që të lexojnë tekstin “*Bota e ftuar mes miqsh*” në fq. 33 të *Librit të nxënësit* dhe diskutojnë për përmbajtjen e tekstit. U kërkon të vështrojnë fjalitë me shkronja blu;

- kërkon që në fjalinë e parë me shkronja blu të zëvendësojnë fjalët *së bashku, udhëtoj, tifoz* përkatësisht me fjalët: *bashkërisht; shkoj, nisem; dashamirës, amator*. Bën pyetjet: A ndryshon kuptimi i fjalisë? Përse zëvendësimi i fjalëve *së bashku, udhëtoj, tifoz*, përkatësisht, me fjalët *bashkërisht, bashkë; shkoj, nisem; dashamirës, amator* nuk e ndryshon kuptimin e fjalisë? Çfarë raportesh kanë fjalët *së bashku, udhëtoj, tifoz*, përkatësisht, me fjalët *bashkërisht; shkoj, nisem; dashamirës amator* dhe si quhen ato?;

- nxjerr përfundimet që fjalët me kuptime të afërta ose të njëjta *tifoz (futbolli), dashamirës (futbolli), amator (futbolli)*, por të ndryshme nga ana tingullore, janë sinonime, që sinonimet mund të zëvendësojnë njëri-tjetrin, pa i ndryshuar kuptimin fjalisë ose paragrafit të dhënë, që sinonimet, domethënë ato që kanë plotësisht të njëjtin kuptim në të gjitha kontekstet, janë shumë të rralla, që ka gjithmonë një dallim të vogël përdorimi. P. sh. *veturë* është më e përdorshme se *automobil*, që sinonimet dallohen edhe në vartësi të kontekstit. Kështu për shembull *largohu* dhe *zhduku* nuk mund të përdoren në të njëjtën situatë;

- kërkon nga nxënësit të lexojnë fjalinë e dytë me shkronja blu dhe u kërkon që të zëvendësojnë fjalët *i lumtur, kënaqësi*, përkatësisht, me fjalët *i mërzi, mërzi* dhe pyet: A ndryshon kuptimi i fjalisë? Përse zëvendësimi i fjalëve *i lumtur, kënaqësi* përkatësisht me fjalët *i mërzi, mërzi* e bën të kundërt kuptimin e fjalisë? Çfarë raportesh kanë fjalët *i lumtur, kënaqësi* përkatësisht me fjalët *i mërzi, mërzi* dhe si quhen ato?;

- nxjerr përfundimet që *antonimet* janë fjalë me kuptime të kundërta (*i lumtur ~ i mërzi, hyj – dal, i gjatë- i shkurtër, shumë- pak*), që antonimet mund të jenë të formuara edhe nga e njëjta fjalë me anë të një parashtese me kuptim mohues: *dituri – padituri, besim- mosbesim, shkencor – joshkencor; qep – shqep, veprim – kundërveprim* etj.;

- kërkon nga nxënësit të lexojnë edhe njëherë tekstin;

- bën pyetjet: Cili është kuptimi i fjalëve *botë, skuadër, bar* në tekstin e mësipërm? A dini fjalë që shkruhen e shqiptohen njësoj si këto, por që kanë kuptim tjetër? Çfarë raportesh kanë fjalët *botë* “rruzulli i Tokës” dhe *botë* “baltë, dhe”; fjalët *skuadër* “në sport” dhe *skuadër* “vegël që përdoret në ndërtim”; *bar* “bimë”, *bar* “lokal” dhe *bar* “njësi matje e shtypjes atmosferike” dhe si quhen ato?;

- nxjerr përfundimet që *homonimet* janë fjalë që përputhen nga forma, por dallohen nga kuptimi (*bar* “bimë”, *bar* “lokal” dhe *bar* “njësi matje e shtypjes atmosferike”, *bankë* “banka e shtetit” dhe *bankë* “banka e klasës”, *akrep* “më zuri akrepi” dhe *akrep* “akrepi i sahatit”), që homonimet janë të mirëfillta dhe të pjesshme. Të mirëfillta janë ato homonime që përputhen në të gjitha trajtat e tyre: *pjek (byrekun) – pjek (shokun)*. Të pjesshme janë ato që përputhen vetëm në disa trajta të tyre: *qepa (qep rrobat) – qepa (hëngra qepë); pata (pata punë) – pata (ngordhi pata); çaj (çaj dru) – çaj (pi çaj)*;

- bën kujdes që të mos ngatërrojnë *sinonimet* me *homonimet*, rithekson që sinonimet janë fjalë të ndryshme që kanë kuptim të njëjtë ose të përafërt (*fshat – katund / vajzë – çupë* etj.), kurse *homonimet* fjalë që shkruhen ose shqiptohen *njësoj*, por kanë *kuptime të ndryshme*: *beli (pjesë e trupit të njeriut) – beli (vegël për të punuar tokën)*.

Ora e dytë

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për sinonimet, antonimet dhe homonimet.

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-7, fq. 17, 18, rreth 20-25 minuta. Gjatë 15-20 minutave bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Ora e tretë

Synimi: të projektojnë dhe zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për sinonimet, antonimet dhe homonimet.

Materialet që do të përdoren: fletë ose skeda kartoni.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- i ndan nxënësit në 4 grupe;

- grupit të parë i jep detyrë të gjejë sa më shumë *antonime* dhe t'i rendisë ato sipas rendit alfabetik (në bazë të fjalës së parë në çifte, p.sh. *i afërt- i largët, i bardhë- i zi, i pasur- i varfër...*);

(Disa shembuj për t'u pasur parasysh: *majtas - djathtas; dashuri - urrejtje; i hollë - i trashë; hyj - dal; ditë-natë; i fortë - i dobët; mik - armik; i dendur - i rrallë; besnik - jobesnik; i mirë - i keq; i ëmbël - i hidhur; i gëzuar - i trishtuar; punëtor - dembel; i shëndetshëm - i sëmurë; i bukur - i shëmtuar; i pasur - i varfër; plot - bosh*);

- grupit të dytë i jep si detyrë të shkruajë sa më shumë *sinonime* dhe t'i rendisë ato sipas rendit alfabetik, në bazë të fjalës së parë në grup, p.sh: *flas - rrëfej, them, tregoj ... ; gosti - darkë, festë, banket ... ; urgjent - i nxituar, i shpejtë, ...;*

(Disa shembuj për t'u pasur parasysh nga mësuesi: *zjarr - flakë - flakadan - prush - vatër ; panair - pazar ; inat - zemërim ; poezi - vjershë ; cilësi - veçori - karakteristikë - shenjë ; burim - krrua - gurrë ; mendoj - arsyetoj - logjikoj - marr me mend ; gjithnjë - gjithmonë - vazhdimisht - pandërprerë - pa pushuar ; i dashur - i këndshëm - i ëmbël ; shtëpi - banesë - pallat, apartament, kullë ; gosti - darkë - banket - festë - gostitje*);

- grupit të tretë i jep si detyrë të gjejë sa më shumë *homonime* të përdorura në kontekst, t'i rendisë ato sipas rendit alfabetik dhe të shpjegojë ndryshimet kuptimore të tyre në. P.sh. *Mos me mëso gjeografinë pa atlas (përmbledhja e hartave gjeografike).; Këmisha është prej atlas (pëllhurë mëndafshi e shndritshme).; Ka gjetur një xhevahir (gur i çmuar).; Është djalë xhevahir (i mirë, i dashur)*;

(Disa shembuj për t'u pasur parasysh nga mësuesi : *Gjyshi i tij kishte qenë bari. Bari kishte filluar të thahej. Ishte mot i vrenjtur. Djali ishte i vrenjtur. U kthye nëna ime e shtrenjtë. Këmisha ishte e shtrenjtë. Nëna me bleu një fund të bukur. Filmi kishte fund tragjik. Lule mushka kishte çelur. Hedh shkelma si mushka. Ajo bleu një fustan atlas. Atlasi e ndihmonte shumë në mësim. Ishte ditë e hënë. Në qiell shndriste një hënë e plotë. Ai ka ishte plak. Ai ka një fytyrë të ëmbël. Gjyshi lidhi brezin. Gjyshi im është më i shquari në brezin e vet. Gryka e malit oshtinte nga suferina. Gryka e shishes ishte e ngushtë*);

- grupi i katërt merr skedat prej kartoni ose fletët me antonime, sinonime dhe homonime të shkruara dhe i ndan në tri grupe të veçanta, antonimet, sinonimet dhe homonimet dhe i rëndit secilin sipas rendit alfabetik duke krijuar kështu *Fjalorin e sinonimeve, të antonimeve dhe të homonimeve*.

- cakton si kohë pune 20 minuta për çdo grup.;

- kërkon që grupet të përshkruajnë në kundërvënie veçoritë fizike dhe morale të një personazhi pozitiv dhe të një personazhi negativ duke përdorur sa më shumë antonime, po, po qe e mundur, edhe sinonime dhe homonime. Përshkrimi duhet të jetë i shkurtër dhe të paraqesë tiparet fizike dhe shpirtërore, veshjen ose aspekte të tjera të renditura në mënyrë logjike ;

- cakton si kohë pune 15 minuta për çdo grup; përfaqësuesi i çdo grupi ka në dispozicion 1 minutë për të paraqitur përshkrimin;

- kërkon vlerësimin e nxënësve për tekstet e shkruara. Zgjedhin përshkrimin e bërë në mënyrën më bindëse e më origjinale dhe argumentojnë përzgjedhjen e vet (koha për punë është 5 minuta).

Vërejtje: Mësues-i/ja, nëse e sheh të nevojshme, mund të përdorë edhe një orë tjetër mësimi për këtë temë. Ndarja e mësimeve në orë mësimi, nuk është detyrueshme për mësues-in/en.

Vërejtjet e mësuesit:

Ndryshimi i emrave

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit rasat dhe lakimin e emrave dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të thonë se çfarë dinë ose mendojnë për vjetërsinë e sportit në përgjithësi dhe për lojërat olimpike në veçanti;
- i fton nxënësit që të lexojnë pjesën “*Nga historia e sportit*” në fq. 38 të *Librit të nxënësit* dhe të diskutojnë për përmbajtjen e tij ;
- u kërkon të vështrojnë fjalët me shkronja zeza. Pyet: A ndryshon emri *sport* gjatë përdorimit në fjali? Çfarë ndryshon, kuptimi apo forma? Cila pjesë e fjalës ndryshon? Si quhet ajo? Sa herë është shkruar me shkronja kursive emri *sport* në tekstin e mësipërm? Cilët janë në numrin njëjës dhe cilët në numrin shumës?;
- së bashku nxjerrin përfundimet që emri ndryshon gjatë përdorimit në fjali, që ndryshon forma dhe jo kuptimi i emrit, që pjesa që ndryshon quhet mbaresë;
- pyet: Si quhen format e ndryshme që merr emri (*e sporteve, sportin, i sportit, sporte, sportet*) gjatë përdorimit në fjali? Si quhet ndryshimi i emrave sipas rasave?
- gjatë diskutimit nxjerrin përfundimet që format e ndryshme që merr emri gjatë përdorimit në fjali janë *rasa*, që ndryshimi i emrave sipas rasave quhet *lakim*;
- u kërkon të vështrojnë tabelën me pyetjet për rasat e emrit dhe i pyet: Me çfarë pyetjesh gjenden rasat e emrave? U kërkon që në vend të vijave, të vënë emrin *sport* në rasën që duhet. Mbi bazën e tabelës vijuese, u kërkon të thonë pyetjet për çdo rasë;
- u kërkon nxënësve të vështrojnë tabelën me trajtat e emrave dhe u kërkon të thonë në sa trajta dhe numra përdoren emrat dhe arrijnë në përfundimin që emrat kanë dy trajta, të shquarën dhe të pashquarën dhe dy numra: njëjës dhe shumës;

Ora e dytë

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për lakimin e emrave.

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-7, fq. 19, 20. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtje: Mësues-i/ja, nëse e sheh të nevojshme, mund të përdorë edhe një orë tjetër mësimi për këtë temë ose mund të bëjë një kombinim të ndryshëm me orët e ushtrimeve. Ndarja e mësimëve në orë mësimi, nuk është detyrueshme për mësues-in/en.

Vërejtjet e mësuesit:

Ndryshimi dhe shkallët e mbiemrave

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit rasat dhe lakimin e mbiemrave dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të thonë se çfarë kanë mësuar për sportin në Greqinë e vjetër dhe në Perandorinë romake;

- pyet nëse dinë diçka për historinë e sportit në Egjiptin e lashtë;

- i fton nxënësit që të lexojnë pjesën “*Nga historia e sportit, Egjipti i lashtë*” në fq. 41 të *Librit të nxënësit* dhe të diskutojnë për përmbajtjen e tij;

- u kërkon të vështrojnë grupet e fjalëve me shkronja blu;

- pyet: Çfarë janë grupet e fjalëve me shkronja blu? dhe u kërkon të gjejnë emrin bërthamë të grupeve emërore me shkronja blu;

- pyet: Çfarë tregojnë fjalët: *e vjetra, të veçantë, egjiptiane, e treguar*? Çfarë kategorie gramatikore i përkasin fjalët *e vjetra, të veçantë, egjiptiane, e treguar*?

- gjatë diskutimit nxjerrin përfundimin që mbiemri tregon një cilësi ose një karakteristikë të sendit, të dukurisë ose të frymorit të treguar nga emri;

- u kërkon të lexojnë edhe një herë grupet e fjalëve me shkronja blu dhe bën pyetjet: Çfarë trajte, gjinie dhe numri kanë emrat *shkrimet, uniformë, traditë, epërsinë* të grupeve emërore me ngjyrë blu? çfarë pyetjeje i përgjigjen emrat e mësipërm? Në çfarë rase janë emrat *shkrimet, uniformë, traditë, epërsinë*? Në çfarë gjinie dhe numri janë mbiemrat *e vjetra, të veçantë, egjiptiane, e treguar* që i shoqërojnë? Si e përcaktuan gjininë dhe numrin e mbiemrave? Në çfarë rase janë mbiemrat *e vjetra, të veçantë, egjiptiane, e treguar*? Si e përcaktuan rasën e mbiemrave?;

- u kërkon të vështrojnë tabelën me rasat e mbiemrit dhe u drejton pyetjet: Me kë përshtatet në gjini dhe numër mbiemri? A ndryshon mbiemri sipas rasave? Sa rase ka mbiemri? Me kë përshtatet në rasë mbiemri?;

- së bashku nxjerrin përfundimet që mbiemri, zakonisht, qëndron *pas* emrit që përcakton dhe përshtatet në *gjini*, në *numër* dhe në *rasë* me të;

- u kërkon të gjejnë mbiemrat e tjerë në tekstin e këtij mësimi dhe të thonë gjininë, numrin dhe rasën e tyre;

- u kërkon të vërejnë tabelën me shkallët e mbiemrit dhe pyet: Sa shkallë ka mbiemri? Çfarë tregon mbiemri në shkallën *pohore*? Çfarë tregon mbiemri në shkallën *krahasore*? Si është ndërtuar shkalla krahasore e mbiemrit? Çfarë tregon mbiemri në shkallën *sipërore*? Si është ndërtuar shkalla sipërore?;

- së bashku nxjerrin përfundimin që mbiemrat kanë tri shkallë: *pohoren, krahasoren* dhe *sipëroren*, që shkalla krahasore formohet me ndihmën e pjesëzës *më*, kurse sipërorja me ndihmën e ndajfoljes *shumë*, që mbiemrat që tregojnë *lëndë, radhë, kohë, vend* etj., nuk përdoren në shkallën krahasore e sipërore: *dorezë e hekurt, dita e parë, gazeta e sotme, populli shqiptar* etj.

Ora e dytë

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për lakimin dhe shkallët e mbiemrave.

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-3, fq. 21. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtje: Mësues-i/ja mund t'i bashkojë në një orë mësimi edhe ushtrimet, nëse e sheh të arsyeshme. Ndarja e mësimeve në orë mësimi, nuk është detyrueshme për mësues-in/en.

Vërejtjet e mësuesit:

Numërorët

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit numërorët dhe disa veçori të tyre, si edhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të thonë nëse e dinë se cili është stadiumi më i madh i futbollit në botë ose çfarë dinë ata për numrin e vendeve në një stadium futbollit etj.;

- i fton nxënësit që të lexojnë pjesën “*Stadiumi Marakana*” në fq. 44 të *Librit të nxënësit* dhe të diskutojnë për përmbajtjen e tij;

- u kërkon të vështrojnë grupet e fjalëve me shkronja blu. I pyet: Çfarë tregojnë fjalët me ngjyrë blu? Çfarë janë fjalët me ngjyrë blu?

- u kërkon të lexojnë fjalitë me shkronja blu, që vijnë pas tekstit dhe të vështrojnë përdorimin e numërorit *dyqind mijë* në fjali. I pyet: A ndryshon sipas rasave numërori *dyqind mijë*? dhe u kërkon ta vërtetojnë. I pyet nëse ndryshon numërori *dyqind mijë* sipas gjinisë? Dhe u kërkon ta provojnë. Për këtë mund të sillen shembuj të përdorimit të tij ose të një numërori tjetër me emra të dy gjinive (*dhjetë djem, dhjetë vajza* etj.);

- nxjerrin përfundimin që numërorët në përgjithësi nuk e kanë kategorinë e gjinisë dhe të rasës;

- vazhdon me pyetje për dy pasqyrat e tjera: A e ka kategorinë e gjinisë numërori *tre*? Çfarë tregojnë numërorët *të dy, të tre..., të dyja, të tria...?* A e kanë kategorinë e gjinisë numërorët *të dy, të dyja, të tre, të tria ...?* A ndryshojnë sipas rasave numërorët *të dy, të dyja* etj.?

- gjatë diskutimit nxjerrin përfundimin që vetëm numërori *tre* e ka kategorinë e gjinisë, që numërorët *të dy, të tre..., të dyja, të tria ...* kanë kuptim përmbledhës, që numërorët me kuptim përmbledhës *të dy, të tre..., të dyja... etj. të tria ...* kanë kategorinë e gjinisë dhe ndryshojnë sipas rasave;

- kërkon të lexojnë pasqyrën me lakimin e fjalëve që tregojnë radhë: vendi *i parë, vendi i dytë...* etj. dhe bën pyetjet: Çfarë tregojnë fjalët *i parë, i dytë, i tretë* etj.? Me kë përshtaten në gjini dhe numër? A ndryshojnë fjalët që tregojnë radhë sipas rasave? Me cilën pjesë të ligjëratës përshtaten në rasë? Çfarë janë fjalët që tregojnë radhë?

- së bashku nxjerrin përfundimet që fjalët që tregojnë radhë: *i parë, i dytë* etj. përshtaten në gjini e numër me emrat përkatës, që ata ndryshojnë dhe përshtaten në rasë me emrin, ashtu si mbiemrat, që ata do të trajtohen si mbiemra dhe jo si numërorë.

Ora e dytë

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për numërorët dhe lakimin e tyre.

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-4, fq. 22. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësuesit:

Struktura e tekstit

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit strukturën bazë të një teksti, hyrjen, zhvillimin, mbylljen, si edhe ta zbatojnë atë në praktikën e analizës së teksteve dhe të hartimit të teksteve prej tyre.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të flasin për qytetin e Ulqinit, për çdo gjë që dinë për të, shtrirja, historia, natyra, njerëzit me veshjet e zakonet e tyre, zhvillimi ekonomik-shoqëror etj. Kërkesat duhet të jenë gjithmonë në përputhje me veçoritë e moshës së tyre;

- i fton nxënësit që të lexojnë tekstin pa titull në fq. 48-49 të *Librit të nxënësit* dhe të diskutojnë për përmbajtjen e tij;

- pyet: Cili titull i përshtatet më mirë tekstit: a) E kaluara e Ulqinit; b) Ulqini gjatë historisë; c) Ulqini dje dhe sot; ç) Detaria e Ulqinit; d) Ulqini udhëkryq i kulturave dh) ... ?;

- u kërkon të zgjidhin njërin nga titujt e propozuar ose të propozojnë dhe të argumentojnë një titull tjetër;

- u kërkon ta rilexojnë tekstin dhe i pyet se si quhen, përkatësisht, pjesët e tekstit të shënuara me numrat 1, 2, 3;

- gjatë diskutimit arrijnë në përfundimin që tekstet zakonisht kanë tri pjesë themelore, *hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen*;

- u kërkon ta analizojnë tekstin nga përmbajtja dhe të përcaktojnë problematikën e trajtuar, duke veçuar çështjet kryesore (plani i pjesës);

- së bashku arrijnë në përfundimin që problemet themelore që trajtohen janë pak a shumë: 1. Themelimi i qytetit të Ulqinit, 2. Qyteti i Ulqinit në periudhën e Mesjetës, 3. Qyteti i Ulqinit në periudhën e Bushatlinjve dhe 4. Detaria e Ulqinit. Sigurisht nxënësit janë të lirë të paraqesin variantet e tyre, të cilat, po qe se përputhen me përmbajtjen, nuk ka përse të kundërshtohen nga mësuesi;

- mbi bazën e nëntemave të paraqitura në tekstin në fq. 49 të *Librit të nxënësit* u kërkon nxënësve ta ritregojnë përmbajtjen e tekstit.

Ora e dytë

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për strukturën e tekstit.

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-3, fq. 27, 28. Pastaj bëhet kontrolli i ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësuesit:

Përemrat vetorë

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit përemrat vetorë, lakimin dhe trajtat e shkurtra të tyre dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të thonë se për se flitet në tekstin “*Rozafati*” (fq. 51). I pyet: Ku ndodhet kalaja e Rozafatit? Sa e vjetër është? Kush e ka ndërtuar? A janë të vërteta ato që thuhet në këtë tekst? Çfarë dini ju për legjendën e ndërtimit të kalasë së Rozafatit? Mund t'i nxisë të bëjnë një krahasim edhe me kalanë e Ulqinit;

- u kërkon të lexojnë edhe një herë tekstin dhe të vështrojnë grupet e fjalëve me shkronja rozë dhe bën pyetjet : Kush i përshëndet tre vëllezërit? Cila prej fjalëve me shkronja rozë ka lidhje me plakun? Çfarë fjale përdor plaku në vend të emrit të vet? Po tre vëllezërit, çfarë fjale përdorin për veten e tyre? Çfarë tregojnë fjalët *ti, unë, ne, atë, ju, ata* ? Çfarë janë fjalët *ti, unë, ne, atë, ju, ata* që zëvendësojnë emrat *plaku* (ti, unë), *atë* (mëkatin, kunatën) *vëllezërit* (ne, ju, ata) që marrin pjesë në bisedë? Çfarë tregojnë fjalët me ngjyrë blu *e, ta, i, na, u, t'ju* në tekstin Rozafati? Çfarë janë ato?;

- gjatë diskutimit nxjerrin përfundimin që fjalët *unë, ne, atë, ju, ata* që zëvendësojnë emra që janë përmendur më parë (*plaku, mëkati, kunatë, vëllezër*) janë *përemra*, që *unë, ti, ai/ajo; ne, ju, ata/ato* janë *përemra vetorë*.

- u kërkon të vështrojnë tabelat përkatëse dhe u bën pyetjet: Sa veta ka përemri vetor? Cilët janë përemrat vetorë të vetës së parë, të dytë, të tretë? A kanë gjini përemrat vetorë të vetës së parë dhe të dytë? A kanë gjini përemrat vetorë të vetës së tretë?

- nxjerrin përfundimin që përemrat vetorë janë të vetës së *parë* (*unë, ne*), të vetës së *dytë* (*ti, ju*) dhe të vetës së *tretë* (*ai, ajo, ata, ato*) dhe se vetëm ata të vetës së tretë ndryshojnë sipas gjinisë;

- u kërkon të vështrojnë tabelat e lakimit të përemrave vetorë dhe u kërkon të diskutojnë për veçoritë e lakimit të tyre. I pyet: Sa trajta kanë përemrat vetorë? Cilat janë ato? Në cilat veta përemrat vetorë kanë trajtë të shkurtër? Në cilat rase përemrat vetorë kanë trajta të shkurtra?;

- nxjerrin përfundimet mbi veçoritë e lakimit të përemrave vetorë dhe përcaktojnë vetat dhe rasat e përdorimit të trajtave të shkurtra (në dhanore mua (*më*), neve (*na*), ty (*të*), juve (*ju*), atij (*i*), asaj (*i*), atyre (*u*), atyre (*u*); në kallëzore mua (*më*), ne (*na*), ty (*të*), ju (*ju*), atë (*e*), atë (*e*), ata (*i*), ato (*i*));

- vazhdon me pyetje për pasqyrën e trajtave të bashkuara. U kërkon të thonë se çfarë venë re në shembujt e kolonës së parë, se çfarë tregojnë dhe çfarë janë *ma, ta, ia, na e, jua, ua, m'i, ia, na i, jua, ua*?;

- nxjerrin së bashku përfundimin që shpesh dy trajta të shkurtra bashkohen dhe formojnë një *trajtë të bashkuar*;

- u kërkon të lexojnë edhe një herë tekstin në fillim të mësimi dhe të komentojnë përdorimin e trajtave të shkurtra. U kërkon t'i zëvendësojnë trajtat e shkurtra me trajta të plota dhe nxjerrin përfundimin që nuk mund të zëvendësohen.

Ora e dytë

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për vetorët dhe lakimin e tyre.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-6, fq. 29. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtje: Mësues-i/ja mund t'i kushtojë edhe një orë më shumë, pra, tri orë gjithsej kësaj teme, në qoftë se e sheh të nevojshme. Ndarja e mësimeve në orë mësimi, nuk është detyrueshme për mësues-in/en.

Vërejtjet e mësuesit:

Përcaktori dhe ndajshtimi

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit përcaktorin dhe ndajshtimin dhe t'i përdorin drejt ata në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të thonë nëse dinë diçka për ishullin Ada, ku ndodhet, sa i madh është, përse paraqet interes etj.

- u kërkon të lexojnë tekstin me titull “Ada” në fq. 55 të *Librit të nxënësit* dhe bën pyetjet: Ku ndodhet ishulli Ada? Çfarë madhësie ka? Çfarë tregohet për historinë e formimit të tij? Çfarë janë ndërtuar në brigjet e Bunës? Përse thotë autori: “*Qetësinë e plotë të saj e thyejnë cicërimat e zogjve dhe shushurima e valëve.*”;

- u kërkon të lexojnë fjalinë me shkronja blu “*Qetësinë ...*” në fq. 55 të *Librit të nxënësit* dhe, pasi ka kërkuar të nënvizojnë emrat (*qetësia* dhe *shushurima*) i pyet: Si është qetësia? Si janë shushurimat? Cilat fjalë janë përdorur për të përshkruar qetësinë dhe shushurimat? Çfarë janë ato, mbiemra, përemra, numërorë apo emra? dhe kërkon ta argumentojnë përgjigjen;

- u kërkon të lexojnë pjesën mes dy vijave blu dhe të vështrojnë grupet e fjalëve me shkronja blu dhe rozë. Bën pyetjet: Me cilat fjalë lidhen fjalët me ngjyrë blu ? Çfarë janë fjalët *grykë, kohë, vit, komandë, vend, ishuj* me të cilat lidhen fjalët *e lumit, para jo shumë, 1858, Naporelit, këtë, dy, të vegjël* me ngjyrë blu? Për se shërbejnë ato? Çfarë janë fjalët: *e lumit, para jo shumë, 1851, e Naporelit, këtë, dy, të vegjël*?

- gjatë diskutimit nxjerrin përfundimin që fjalët *e lumit, para jo shumë, 1851, e Naporelit, këtë, dy, të vegjël* që përcaktojnë emrat *grykë, kohë, vit, komandë, vend, ishuj* janë përcaktorë;

- u kërkon të vështrojnë tabelat që pasojnë dhe u bën pyetjet: Çfarë janë përcaktorët e përdorur, emra, mbiemra, përemra, ndajfolje apo numërorë?

- nxjerrin përfundimin që përcaktori mund të jetë një emër pa parafjalë, një emër me parafjalë, një mbiemër, një përemër, një ndajfolje ose një formë e pashtjelluar foljore;

- u kërkon të lexojnë edhe një herë të njëjtën copë dhe u kërkon të gjejnë emrin bërthamë të grupeve emërore me shkronja blu. Bën pyetjet: A kanë kuptim të njëjtë apo të ndryshëm fjalët *Ada, Bunë, “Merito”, kapiten* në raport me emrin pranë të cilit gjenden? dhe u kërkon të shpjegojnë përgjigjen. I pyet: Përse shërbejnë fjalët: *Ada, Bunë, “Merito”, kapiten*? Çfarë janë fjalët *Ada, Bunë, “Merito”, kapiten*?;

- së bashku arrijnë në përfundimin që një emër ose grup emëror, që ka kuptim të njëjtë ose të ngjashëm me emrin pranë të cilit gjendet, është një ndajshtim; që ndajshtimi është një lloj përcaktori;

- u kërkon të shohin pasqyrat dhe i pyet: Cilës kategorie gramatikore i përkasin ndajshtimet *Ada, Bunë, “Merito”, kapiten*? Në çfarë rase janë emrat ndajshtim?

- nxjerrin përfundimin që ndajshtimi *jo i veçuar* shprehet me emër në rasën emërore;

- u kërkon të lexojnë fjalitë: *Qyteti Ulqin ndodhet në afërsi të Bunës. Ulqini, qytet i lashtë, ndodhet në afërsi të Bunës.* Bën pyetjet: Çfarë janë fjalët *Ulqin, qytet i lashtë*?

Çfarë dallimi ka ndërmjet këtyre dy ndajshtimeve? Si shënohet ndajshtimi i veçuar në të folur? Me se shënohet ndajshtimi i veçuar në shkrim? Çfarë është ndajshtimi i veçuar?;

- arrijnë në përfundimin që ndajshtimi i veçuar, në të folur, veçohet nga emri që përcakton me një pushim të shkurtër, kurse në të shkruar me përdorimin e presjes.

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për përcaktorin dhe ndajshtimin.

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-7, fq. 30. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtje: Mësues-i/ja mund t'i kushtojë edhe një orë më shumë, pra, tri orë gjithsej kësaj teme, në qoftë se e sheh të nevojshme. Ndarja e mësimeve në orë mësimi, nuk është detyrueshme për mësues-in/en.

Vërejtjet e mësuesit:

E vërtetë apo legjendë

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të kuptojnë nxënësit se tekstet ndryshojnë nga njëri-tjetri. Për ilustrim kemi marrë tekstin e një legjende që ndryshon nga tekstet e trajtuara deri tani për sa i përket përmbajtjes, personazheve dhe stilit. Është një tekst që dallohet nga artikujt e tipi gazetaresk ose shkencor.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- i pyet nxënësit nëse kanë dëgjuar për bëmat e Mujit dhe Halilit dhe të kreshnikëve të tjerë ose për zanat e malit. U kërkon të tregojnë gjithçka dinë ose kanë dëgjuar për to; mund të sjellë libra, piktura dhe çdo gjë tjetër që lidhet me ciklin e kreshnikëve për ta gjallëruar bisedën dhe nxitur fantazinë e tyre.;

- i fton nxënësit që të lexojnë tekstin me titull “*Fuqia e Mujit*” në fq. 60-62 të *Librit të nxënësit* dhe të diskutojnë për përmbajtjen e tij;

- pyet nxënësit: Ku zhvillohen ngjarjet? Kur zhvillohen? Kush ishte Muji? Çfarë i ndodhi Mujit? Çfarë bënë zanat për të ndihmuar Mujin? etj.;

- pas këtyre pyetjeve riprodhuese që lidhen me përmbajtjen dhe kanë si synim fiksimin e ngjarjeve kryesore të parashtruara në tekstin e lexuar, kalon në pyetje arsyetuese e interpretuese të tipit: Ku dallohet Muji nga qeniet e tjera njerëzore? Si i përfytyroni ju zanat? Përse zanat e bënë Mujin vëllam?

- vijon me pyetje që lidhen me veçoritë e tekstit: Deri në çfarë mase janë reale ngjarjet e këtij teksti? Çfarë është ky tekst: a) një artikull gazete, b) një punim shkencor, c) një gojëdhënë apo legjendë?

- nxjerrin përfundimin që në këtë tekst tregohen ngjarje që mund të kenë ndodhur, po që janë shtuar e zbuluar nga fantazia e popullit, që ky tekst është një legjendë dhe si i tillë ai ndryshon nga tekstet shkencore ose artikujt e gazetave të përditshme;

- u kërkon të përcaktojnë hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen e këtij teksti dhe të kërkojë ritregimin e tij mbi këtë bazë.

Ora e dytë

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për gojëdhënë ose legjendën, nëpërmes një teksti të ngjashëm me të.

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-4, fq. 31. Pastaj bëhet kontrolli i ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësuesit:

Fjalìa e thjeshtë dhe e përbërë

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit fjalinë e thjeshtë dhe të përbërë dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të lexojnë pjesën e shkëputur nga teksti “*Fuqia e Mujit*”, ku janë shënuar me ngjyrë blu foljet dhe pyet: A mund t'i heqim fjalët me ngjyrë blu dhe teksti të mbetet i kuptueshëm? Çfarë tregojnë fjalët me ngjyrë blu? Çfarë janë fjalët me ngjyrë blu që tregojnë ç'bën, ç'pëson ose gjendjen e dikujt apo të diçkaje?;

- nxjerrin përfundimin që fjalët që tregojnë ç'bën, ç'pëson ose gjendjen e dikujt apo të diçkaje janë folje dhe që folja është fjala kryesore në fjali.

- u kërkon të lexojnë fjalitë e grupuara në A dhe B. Pyet: Sa folje ka secila nga fjalitë e grupit A dhe B? U kërkon që, mbi bazën e tabelës që vijon, të përcaktojnë fjalitë e thjeshta dhe të përbëra;

- nxjerrin përfundimin që fjalia e thjeshtë ka një folje, kurse fjalia e përbërë më shumë se një folje;

- u kërkon të lexojnë fjalitë e thjeshta që pasojnë faqe... dhe i pyet : A mund të heqim fjalë nga këto fjali të thjeshta dhe fjalitë të kenë kuptim?

- arrijnë në përfundimin që fjalitë e thjeshta janë dy llojesh, minimale dhe të zgjeruara, që fjali të thjeshta minimale janë ato nga të cilat nuk mund të hiqet asnjë fjalë (*Djepet ishin te shkëmbi. Djepet kishin dy foshnja. Foshnjat ishin të njoma.*) se bëhen fjali pa kuptim, pra, lloji i fjalisë, minimale, e zgjeruar, e përbërë nuk përcaktohet nga numri i fjalëve, po nga numri i foljeve kallëzues dhe nga tërësia kuptimore.

- u kërkon të përcaktojnë fjalët e thjeshta dhe të përbëra dhe llojet e fjalive të thjeshta duke u nisur nga tabela që vjen pas;

- u kërkon të lexojnë pjesën në vazhdim dhe i pyet: Sa fjali ka në këtë pjesë? Çfarë fjalish janë, të thjeshta apo të përbëra? Fjalitë e thjeshta janë minimale apo të zgjeruara? dhe u kërkon ta argumentojnë përgjigjen.

Ora e dytë

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për fjalinë e thjeshtë dhe të përbërë.

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-4, fq. 32. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësuesit:

Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit ligjëraten e drejtë dhe të zhdrejtë dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon nxënësve të thonë çfarë librash kanë lexuar kohët e fundit dhe nëse kanë dëgjuar diçka për librin e Mitrush Kutelit “*Tregime të moçme shqiptare*”. Po të ketë mundësi, ua tregon librin dhe u thotë diçka për përmbajtjen e tij, se teksti “*Fuqia e Mujit*”, që kanë lexuar, është marrë nga ky libër.

- u kërkon të vështrjnë figurën në fq. 65 të *Librit të nxënësit* dhe u kërkon të lexojnë me zë fjalët e Ilirit, Anës, Erës dhe Zanës. U kërkon të krahasojnë fjalitë e dialogut me fjalitë e shkruara më poshtë. Bën pyetjet: Çfarë ndryshimesh vini re? Pse ndryshojnë?;

- nxjerrin konkluzionin që fjalitë e thëna nga dikush (- Do të shkoj sot në bibliotekë të marr librin me gojëdhëna shqiptare.) mund të përmenden nga të tjerët ashtu siç janë thënë (Iliri tha: “*Do të shkoj në Bibliotekë të marr librin me legjenda të vjetra shqiptare.*”)

- u kërkon të vështrjnë me kujdes fjalitë që vijnë dhe i pyet: Në sa mënyra është dhënë ligjërata e drejtë?

- nxjerrin përfundimin që, në ligjëraten e drejtë, fjalët e autorit mund të vendosen para, në mes a në fund të ligjërates së drejtë;

- përqendron vëmendjen në përdorimin e shenjave të pikësimit. Bën pyetjet: Çfarë shenjash pikësimi janë përdorur gjatë shkrimit të ligjërates së drejtë? Ç’rol kanë thonjëzat? Në cilin variant të ligjërates së drejtë përdoren dy pikat? Me ç’shkronjë fillon ligjërata e drejtë? Ku dallohet varianti i dytë i ligjërates së drejtë nga i pari? U kërkon të shpjegojnë veçoritë e ligjërates së drejtë në shembullin e tretë?

- nxjerrin përfundimin që ligjërata e drejtë vihet midis thonjëzash, që, kur ligjërata e drejtë qëndron pas fjalëve të autorit, para saj vihen dy pika dhe fjala e parë e ligjërates së drejtë fillon me shkronjë të madhe, që kur ligjërata e drejtë qëndron para fjalëve të autorit, pas saj vihet presje dhe vizë, dhe fjalët e autorit fillojnë me shkronjë të vogël, që ligjërata e drejtë mund të ndahet më dysh nga fjalët e autorit, dhe se kur ligjërata e drejtë është një fjali e vetme, para dhe pas fjalëve të autorit vihet presje dhe vizë, kurse kur pjesa e dytë është një fjali tjetër, atëherë pas fjalëve të autorit vihet pikë dhe vizë.

- u kërkon të krahasojnë të njëjtin tekst në ligjërata të drejtë dhe të zhdrejtë dhe u kërkon të përcaktojnë dallimet ndërmjet tyre.

- nxjerrin përfundimin, se gjatë zëvendësimit të ligjërates së drejtë me ligjërata të zhdrejtë ndryshojnë foljet dhe përemrat.

Vërejtje: Mësues-i/ja mund t'i kushtojë edhe një orë më shumë, pra, dy orë gjithsej kësaj teme, në qoftë se e sheh të nevojshme. Ndarja e mësimeve në orë mësimi, nuk është detyrueshme për mësues-in/en.

Ora e dytë

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për ligjëraten e drejtë dhe të zhdrejtë

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-6, fq. 33, 34. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

- bën diktim. Teksti i diktimit:

Im atë thoshte: “Njeriu, mbahet mend për të mirë ose për të keq në jetë.”

“Përtacia për njeriun,- thoshte ai, - është si ndryshku për hekurin.”

“Sa i mirë është babai!” - mendonte Blerta.

- i paralajmëron që të kenë kujdes për shenjat e pikësimit.

Vërejtjet e mësuesit:

Llojet e fjalisë së thjeshtë

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit llojet e fjalive të thjeshta (dëftore, dëshirore, pyetëse, nxitëse) dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon nxënësve të lexojnë tekstin në hyrje të mësimi me zë të lartë dhe me intonacionin e duhur. Bën pyetjet: Cilat fjali japin një informacion ose tregojnë diçka? Cilat fjali kërkojnë një sqarim ose pyesin për diçka? Cilat fjali shprehin një dëshirë? Cilat fjali nxisin dikë për të bërë diçka? Si quhen fjalitë që japin një informacion ose tregojnë diçka? Si quhet fjalia që pyet për diçka? Si quhet fjalia që shpreh një urim? Si quhet fjalia që shërben për të nxitur dikë që të veprojë? Çfarë shenja pikësimi janë përdorur pas fjalive dëftore, pyetëse, dëshirore dhe nxitëse?

- në bashkëpunim me nxënësit nxirren konkluzionet që fjalitë e thjeshta mund të jenë: *dëftore, pyetëse, nxitëse* ose *dëshirore, që fjalia dëftore* tregon diçka, jep një informacion ose një mendim, që fjalia *pyetëse* pyet për diçka ose kërkon një sqarim, që fjalia *nxitëse* nxit ose ndalon dikë të zbatojë një urdhër, të japë një këshillë ose të bëjë një ftesë, që fjalia *dëshirore* shpreh një dëshirë, një urim ose një mallkim;

- u kërkon të vështrajnë skemën në vazhdim dhe të thonë llojet e fjalisë së thjeshtë duke pasur parasysh edhe shembullin përkatës për ilustrim;

- u kërkon të lexojnë me zë të lartë dhe me intonacionin e duhur tekstin “*Trimi Dedi Skura*” në fq. 68 të *Librit të nxënësit*. Bën pyetjet: Çfarë fjalish janë fjalitë me shkronja blu, të thjeshta apo të përbëra? Cilat nga këto fjali janë *dëftore, pyetëse, nxitëse* dhe *dëshirore*? Çfarë vini re në shqiptimin e fjalive: - *Ç’ke bërë kështu, o Dedi Skura?! Ti e paske mbushur kodrën me të vrarë! Të lumtë dora!* Si quhen fjalitë *dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore* që shqiptohen me ndjenjë ose emocion? Çfarë shenja pikësimi vihen pas fjalive thirrmore?;

- Nxjerrin përfundimin që fjalitë *dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore*, kur shqiptohen me emocion bëhen *thirrmore*, që në fund të fjalisë *thirrmore* vihet pikëçuditje, që në fund të fjalisë *pyetëse-thirrmore* vihet pikëpyetje dhe pikëçuditje.

Ora e dytë

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për llojet e fjalive.

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-5, fq. 35, 36. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësuesit:

Kryefjala dhe kallëzuesi

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit kryefjalën dhe kallëzuesin foljor e emëror dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë fjalitë në fillim të mësimit nr. 18. Bën pyetjet: Çfarë fjalish janë, të thjeshta apo të përbëra? dhe kërkon ta argumentojnë. Vijon me pyetjet: Çfarë tregojnë emrat me ngjyrë blu? A është e mundur të hiqen? Çfarë funksioni kryejnë? Me çfarë pyetje gjenden? Çfarë janë fjalët me ngjyrë blu? Çfarë pjese ligjërata janë kryefjalët me ngjyrë blu?;

- nxjerrin përfundimin që kryefjala tregon atë për të cilin flasim në fjali, që kryefjala nuk mund të hiqet dhe që kryefjalë mund të jetë *një emër, një përemër ose grup emëror*;

- u kërkon të lexojnë edhe njëherë fjalitë dhe pyet: Çfarë tregojnë fjalët me ngjyrë rozë? A është e mundur të hiqen? Çfarë funksioni kryejnë fjalët me ngjyrë rozë? Me çfarë pyetjesh gjenden? Çfarë janë fjalët me ngjyrë rozë?;

- nxjerrin përfundimin që kallëzuesi tregon, çfarë themi për kryefjalën dhe që kallëzuesi nuk mund të hiqet; u kërkon të lexojnë fjalitë që pasojnë dhe u bën pyetjen: Përcaktoni llojin e kallëzuesit duke u nisur nga tabela që pason;

- nxjerrin përfundimin që kallëzuesi mund të jetë *foljor (folje ose folje+folje) dhe emëror: jam (këpujë) + gjymtyrë emërore (emër, mbiemër, përemër, numëror)*. U kërkon të komentojnë skemat që sintetizojnë strukturën e kallëzuesit emëror dhe foljor;

- me qëllim verifikimi e thellimi të njohurive për kryefjalën, kallëzuesin foljor e emëror në vijim janë dhënë disa fjali dhe kërkesa që i nxitin nxënësit t'i zgjerojnë e verifikojnë njohuritë e tyre të fituara.

Vërejtje: Mësues-i/ja mund t'i kushtojë edhe një orë më shumë, pra, dy orë gjithsej kësaj teme, në qoftë se e sheh të nevojshme. Ndarja e mësimeve në orë mësimi, nuk është detyrueshme për mësues-in/en.

Ora e dytë

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për përcaktorin dhe ndajshtimin.

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-5, fq. 37, 38. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësuesit:

Lajmërimi

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të njohin nxënësit qëllimin dhe rëndësinë e lajmërimeve zyrtare dhe jozyrtare, të shkruajnë vetë lajmërimi të tilla.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon nxënësve të lexojnë lajmërimet në fq. 74 të *Librit të nxënësit*. Bën pyetjet: Si quhet teksti që po lexojnë nxënësit? Kujt i drejtohet? Kush është autori i tekstit? Çfarë dëshiron të bëjë të ditur ai? Kur do të zhvillohet ekskursioni? Ku do të bëhet ekskursioni?

- u kërkon të veçojnë të dhënat kryesore të lajmërimit dhe të thonë se me çfarë pyetje gjenden;

- u kërkon nxënësve të lexojnë dy tekstet (lajmërimet) që pasojnë dhe i pyet: Kujt i është drejtuar teksti i parë? Kush e ka shkruar? Për çfarë e njofton Anila nënën e vet? Si do ta emërtojnë këtë tekst? Kush e ka shkruar tekstin e dytë? Kujt i drejtohet? Për çfarë e njoftojnë zotin Franaj? Ku mund t'i marrë biletat ai? Kur mund t'i marrë ato? Si do ta emërtonin këtë tekst? Çfarë dallimesh venë re në fillimin dhe mbarimin e këtyre dy teksteve? A venë re ndryshime të tjera ndërmjet tyre? Cili prej tyre është zyrtar dhe cili është jozyrtar? dhe të shpjegojnë përgjigjen;

- u kërkon të lexojnë lajmërimin për Ansamblin e Këngëve dhe Valleve popullore dhe ta krahasojnë me lajmërimin e shkollës, të Anilës, si edhe të agjencisë “Montenegro airlines”;

- i pyet: Cilat nga këto lajmërimi i drejtohen një personi? A mund të quhen lajmërimi personale? Cilat lajmërimi i drejtohen publikut? Si mund të quhen ato?;

- u kërkon nxënësve të lexojnë dy tekstet (lajmërimet) që pasojnë dhe i pyet: Kush lajmëron? Kë lajmëron? Për çfarë flitet në këto lajmërimi? Kur do të bëjnë pushim? Pse është i paplotë ky njoftim?;

- u kërkon të shkruajnë të dhënat që mungojnë, që lajmërimi të bëhet i kuptueshëm dhe i saktë dhe u tërheq vëmendjen nxënësve tek informacionet kryesore që duhet të përmbajë lajmërimi (kush e bën lajmërimin, kë lajmëron, për ç'gjë lajmërohet, kur do të ndodhë, ku do të ndodhë);

- vijon me pyetjet: Ç'është lajmërimi? Ç'të dhëna duhet të përmbajë? Sa llojesh janë lajmërimet?;

- nxjerrin përfundimet që lajmërimet janë *zyrtare, jozyrtare, publike* dhe *private* që lajmërimet *zyrtare* vendosen në vende publike ose shpallen në gazeta, radio, televizion, internet, që në lajmërimet zyrtare shënohet *adresa* e institucionit që e bën lajmërimin, *teksti* i lajmërimit dhe *emri* bashkë me firmën e titullarit të institucionit, që *gjuha* e lajmërimeve *zyrtare* është pa fjalë të tepërta dhe pa kuptime të figurshme, që *gjuha* e lajmërimeve *private* është më e çlirët dhe më e afërt me gjuhën e bisedave të përditshme.

Ora e dytë

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-6, fq. 43, 44, 45, 46. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësuesit:

Rrethanori

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit rrethanorët e vendit, të kohës, të mënyrës, të shkakut, të qëllimit dhe të sasisë, si dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë lajmërimin në fillim të mësimi nr. 20. Bën pyetjet: Kush e bën lajmërimin? Kujt i drejtohet lajmërimi? Pse ky lajmërim është zyrtar? Për çfarë flitet në këtë lajmërim? Çfarë tregon grupi i fjalëve *deri me datën 18 dhjetor 2006*? Me çfarë pyetje gjendet? Cilës fjalë i drejtohet pyetja? Çfarë kategorie gramatikore i përket ajo? Si quhet fjala që jep informacion shtesë për atë që tregon folja? Si quhet rrethanori që jep informacion për kohën, kur do të kryhet veprimi? Çfarë pyetje duhet të bëni, që të merrni përgjigje në *Shoqatën Kulturore "Rinia" në Tuz*? Çfarë tregon kjo pyetje? Si quhet rrethanori që tregon vendin ku kryhet veprimi?;

- nxjerrin përfundimin që plotësit, që tregojnë një rrethanë të kryerjes së veprimit (*vend, kohë* etj.) janë *rrethanorë*; që rrethanorët mund t'i *zhvendosim* ose t'i *heqim*, sepse nuk janë të domosdoshëm në fjali; që kuptimet e rrethanorit varen nga informacioni që jep; që ai mund të tregojë *vend, kohë* etj.;

- u kërkon të lexojnë mesazhin e Fatmirës dërguar Zanës dhe bën pyetjet: Çfarë po bën Fatmira? Me se po e njofton Zanën? Për çfarë po e njofton Fatmira Zanën? Ky lajmërim është personal apo zyrtar? U kërkon ta argumentojnë përgjigjen. Vijnë me pyetjet: Çfarë pyetje duhet të bëjmë, që të marrim si përgjigje *sot*? Çfarë tregon fjala *sot*? Çfarë rrethanori është? Çfarë pyetje duhet të bëjmë që të marrim si përgjigje *mirë*? Çfarë tregon fjala *mirë*? Çfarë rrethanori është? Çfarë pyetjesh duhet të bëjmë që të marrim si përgjigje *nga frika, për urim*?;

- nxjerrin përfundimin që rrethanorët mund të tregojnë *vend, kohë, sasi, qëllim, mënyrë, shkak*;

- u kërkon të shohin me kujdes skemën dhe i pyet: çfarë tregojnë rrethanorët? me çfarë pyetjesh gjinden ? çfarë plotësojnë?;

- nxjerrin përfundimin se ka gjashtë lloj rrethanorësh (vendi, kohe, sasi, qëllimi, mënyre, shkak) dhe se gjenden përkatësisht me pyetjet *ku, kur, sa, përse, si, pse* drejtuar foljeve;

- u kërkon të lexojnë tekstin "*Tomi lyen gardhin*" në fq. 80 të *Librit të nxënësit*, ku janë nënvizuar rrethanorët. I pyet: Çfarë rrethanorësh janë? Në paragrafin e parë, cilët prej tyre janë fjalë të ndryshueshme? Po në atë paragraf, cilët prej rrethanorëve janë fjalë të pandryshueshme? Me se janë shprehur rrethanorët e tjerë? Çfarë lloj fjalësh mund të jenë rrethanorë?;

- nxjerrin përfundimin që rrethanorë mund të jenë një grup emëror pa parafjalë, një grup emëror me parafjalë, një ndajfolje, një formë e pashtjelluar foljore;

- u kërkon të vështrojnë tabelën ku paraqiten llojet e fjalëve dhe funksionet e tyre. Përmes analizës së të dhënave të tabelës arrin në përfundimin që puna që kryejnë llojet e fjalëve (*emrat, mbiemrat, numërorët, përemrat, foljet, ndajfoljet, parafjalët, lidhëzat, pjesëzat dhe pasthirrat*) në fjali quhet *funksioni* i tyre (*kryefjalë, kallëzues, përcaktor, ndajshtim, kundrinor, rrethanor*).

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-6, fq. 47, 48. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësuesit:

Emërorja

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit rasën emërore të emrave dhe funksionet e saj dhe ta përdorin drejt atë në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë fjalitë në fillim të mësimit nr. 21. Bën pyetjet: Çfarë janë fjalët me shkronja të pjerrëta? Çfarë funksioni kryejnë? Çfarë pyetjesh u përgjigjen? Si quhet rase që gjendet me pyetjet *kush, cili, çfarë, ç'?*;

- nxjerrin përfundimin që rase emërore gjendet me pyetjet *kush? cili? çfarë? ç'?* dhe se emri në atë rasë kryen funksionin e kryefjalës;

- u kërkon të lexojnë fjalitë: *Xhimi është shoku i Tomit. Xhimi është djalë i sjellshëm.*, në fq. 81 *Librit të nxënësit*. U bën pyetjet: Çfarë funksioni kryen fjala *shoku* (i Tomit)? Çfarë funksioni kryen fjala *djalë* (i sjellshëm)? Çfarë janë fjalët *shoku* (i Tomit), *djalë* (i sjellshëm)? Në çfarë rase janë emrat *shoku, djalë?*;

- nxjerrin përfundimin që emri në rasën emërore mund të jetë pjesë e kallëzuesit emëror;

- u kërkon të lexojnë fjalinë: *Xhimi, shoku i Tomit, është djalë i sjellshëm*. Bën pyetjet: Çfarë funksioni kryen grupi i fjalëve *shoku i Tomit* në këtë fjali? U kërkon ta argumentojnë përgjigjen dhe të thonë se në çfarë rase janë;

- nxjerrin përfundimin që emri në rasën emërore mund të jetë edhe ndajshtim;

- u kërkon të analizojnë funksionet e rasës emërore të paraqitura përmes tabelës dhe nxjerrin përfundimin që emri në rasën emërore mund të jetë kryefjalë, ndajshtim dhe pjesë e kallëzuesit emëror;

- u kërkon të lexojnë fjalinë: *Xhimi! O Xhimi! Ma jep kovën*. Bën pyetjet: *Çfarë tregojnë fjalët Xhimi! O Xhimi?* Çfarë janë fjalët *Xhimi! O xhimi!* që tregojnë personin të cilit i drejtohem? Në çfarë rase janë?;

- nxjerrin përfundimin, që emri në rasën emërore mund të jetë edhe thirrje;

- u kërkon të lexojnë fjalinë: *Tomi desh u rrëzua nga lodhja dhe u mbajt te pema*. Bën pyetjet: Çfarë parafjalësh kanë përpara emrat *lodhje* dhe *pemë*? Në çfarë rase janë? Çfarë tregojnë emrat në rasën emërore me parafjalët *nga, te(k)?*;

- nxjerrin përfundimin, se emri në rasën emërore me parafjalët *nga, tek* tregon: *vend, shkak, kohë, sasi, krahasim* etj.

Ora e dytë

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për rasën emërore.

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-7, fq. 49, 50. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësuesit:

Lajmërimi i vogël

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë nxënësit çfarë është lajmërimi i vogël, çfarë të dhënash duhet të përmbajë, si edhe të shkruajnë vetë lajmërimet të tilla.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon nxënësve të lexojnë lajmërimet në fq. 86 të *Librit të nxënësit*. Bën pyetjet: Cili nga ato tekste dallohet nga të tjerët? Çfarë dallimi ka me tekstet e tjera? Si quhet ky lloj teksti? Po tekstet e tjera si mund t'i emërtojmë? Pse tekstet e tjera kanë në emërtimin e tyre fjalën *i vogël*? Ku mund të gjesh (të lexosh ose dëgjosh) lajmërimet të vogla? U kërkon të gjejnë lajmërimet që kanë të bëjnë me *shitjen*, me *shërbimet*, me *mësimdhënien*, me *turizmin*, me *oferta për punë*. U kërkon të lexojnë lajmërimin që bën fjalë për *blerjen*. I pyet: Çfarë shënohet në fund të çdo lajmërimi? U kërkon të gjejnë lajmërimin që nuk ka numër telefoni. I pyet: Çfarë është dhënë në vend të numrit të telefonit? Çfarë të dhënash duhet të përmbajë një lajmërim?

- nxjerrin përfundimin që lajmërimi *i vogël* është një fletë a shpallje e vogël me të cilin njoftojmë publikun për diçka që kemi humbur ose gjetur, për diçka që duam të blejmë ose të shesim, që ai mund të shpërndahet me dorë, të ngjitet diku, të botohet në gazetë ose të njoftohet me mjetet e sotme të komunikimit (radio, televizion ose internet), që ai duhet të përmbajë numrin e telefonit dhe adresën e atij që shpall diçka;

- u kërkon të shohin lajmërimet që vijnë, por pa i lexuar. Bën pyetjet: Cilat lajmërimet të tërheqin vëmendjen? Pse? Për se shërben ilustrimi në një lajmërim? Cilat fjalë tregojnë qëllimin i lajmërimit? Çfarë tregon vija e pjerrët (/) në lajmërimin e fundit? A mund ta vendosim në lajmërimet e tjera që ofrojnë punë? Ku i gjejmë më shumë lajmërimet e vogla? Nga se dallohen lajmërimet e vogla në faqet e gazetave?

- nxjerrin përfundimet lidhur me funksionin e ilustrimeve për vënien në dukje të lajmërimet të vogla, si edhe mbi disa veçori që lidhen me gjuhën dhe ndërtimin e tyre;

- u kërkon të lexojnë me kujdes lajmërimin e marrë nga interneti dhe të riprodhuar ashtu, siç është shkruar dhe të bëjnë vërejtjet për gjuhën dhe përmbajtjen e tij. Për këtë qëllim u drejton pyetjet: A është shprehur qartë mendimi? dhe u kërkon ta shpjegojnë përgjigjen. U kërkon të shohin me vëmendje renditjen e fjalëve dhe i pyet se cila fjalë duhet zhvendosur, që lajmërimi të jetë më i qartë dhe më i saktë, si edhe çfarë duhet shtuar e ndrequr tjetër në fjalinë e parë, që të dalë i qartë mendimi;

- vijon me pyetjet: Si mund të thuhet më mirë dhe më bukur, shprehja “Zonë e preferuar është gjithë zona nga...”? Çfarë vërejtjesh kanë për shënimin e rrugës: “Rr Tuzit, rr Tuzit? I pyet nëse është në rasën e duhur fjala Samsung dhe u kërkon ta rregullojnë. I pyet se çfarë vërejtjesh të tjera mund të bëhen dhe kërkon të diskutojnë për to. Së fundi, u kërkon të thonë se si duhet të jetë një lajmërim i vogël dhe çfarë informacioni duhet të përmbajë;

- nxjerrin përfundimin që lajmërimi i vogël duhet të jetë *i shkurtër*, *i qartë* dhe *i saktë*.

Ora e dytë

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-4, fq. 51, 52. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësuesit:

Gjinorja

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit rasën gjinore të emrave dhe funksionet e saj dhe ta përdorin drejt atë në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë dy lajmërimet e vogla në fq. 89 të *Librit të nxënësit*. Bën pyetjet: Çfarë janë tekstet e mësipërme? Pse janë njoftime personale dhe jozyrtare? Me cilat fjalë lidhen emrat me shkronja blu? Çfarë pyetjeje u përgjigjen? Si quhet rasa që gjendet me pyetjet *i kujt? i cilit?*;

- nxjerrin përfundimin që rasa gjinore gjendet me pyetjet *i kujt? i cilit?*;

- u kërkon të lexojnë fjalitë : Jam tek shtëpia e Zanës. Po bëjmë detyrat e shtëpisë. Deri tani kemi bërë gjysmën e detyrave. Cirku i Tiranës jep shfaqje në Pallatin e Kulturës. I ke në sirtarin e komosë. Jam me shoqet e klasës. U kërkon të vështrojnë emrat në gjinore. Bën pyetjet: A kanë të njëjtin kuptim emrat në gjinore? Çfarë tregojnë emrat në gjinore? Cili nga emrat në gjinore tregon se kujt i përket diçka, përkatësi? Cili nga emrat në gjinore karakterizon një send? Cili nga emrat në gjinore tregon tërësinë nga ndahet një pjesë? Cili nga emrat në gjinore tregon emërtimin e një vendi a sendi? Cili nga emrat në gjinore tregon vend?;

- nxjerrin përfundimin që emri në rasën gjinore mund të tregojë: përkatësi, lloj, emërtim, tërësinë nga ndahet një pjesë, vepruesin, pësuesin etj.;

- u kërkon të lexojnë fjalitë : *Kanë ardhur libra të rinj në bibliotekën e shkollës. Këngët e dasmës janë shumë të bukura. Kthimi i refugjatëve ra në sy të gjithëve. Një pjesë e ligjeve duhen përmirësuar. Spitali i Plavës është shumë i mirë. Hapja e dritareve një herë në ditë është e domosdoshme.* Nxënësit duhet të plotësojnë tabelën duke shënuar çfarë tregojnë gjinoret me shkronja blu: *përkatësi, lloj, vepruesin, pjesë, emërtim, pësim*;

- u kërkon të lexojnë fjalitë: Gjaku vjen me anë të damarëve në zemër. Rronte në mes të egërsirave. Iku për shkak të dimrit. U bën pyetjet : Në çfarë rase janë emrat me shkronja blu? Çfarë kanë përpara emrat me shkronja blu? Çfarë tregojnë emrat në gjinore të paraprirë nga parafjalët *me anë, nga ana, për arsye, për shkak, me përjashtim* etj.;

- nxjerrin përfundimin që Gjinorja përdoret edhe pas disa lokucioneve parafjalore (*me anë, nga ana, për arsye etj.*) dhe në këtë rast tregon : *mjet, shkak, vend* etj.;

- u kërkon të vështrojnë tabelën e lakimit të emrave në gjinore dhe u bën pyetjet: Në çfarë trajte janë emrat? Në çfarë numri? Çfarë mbaresash kanë në gjinore *të pashquar* emrat e gjinisë mashkullore e femërore në njëjës? Çfarë mbaresash kanë në gjinore *të pashquar* emrat e gjinisë mashkullore e femërore në shumës?;

- nxjerrin përfundimin për sistemin e mbaresave të gjinoreve të emrave të pashquar mashkullore e femërore. Përsëritet e njëjta procedurë për trajtën e shquar mbi bazën e analizës së tabelës përkatëse;

- u kërkon të vështrojnë ilustrimin përkatës për përdorimin dhe funksionet e gjinoreve. Bën pyetjet: Cilat janë kuptimet më kryesore të gjinoreve? Me ç'pyetje gjendet gjinorja? A mund të përdoret gjinorja me parafjalë? Me çfarë parafjalësh përdoret gjinorja?;

- përsërisin dhe sintetizojnë përfundimet e arritura gjatë krejt orës së mësimi për funksionet e gjinoreve.

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për rasën gjinore.

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-5, fq. 53. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësuesit:

Kallëzorja

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit rasën kallëzore të emrave dhe funksionet e saj dhe ta përdorin drejt atë në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë dy lajmërimet e vogla në fillim të mësimi nr. 24. Bën pyetjet: Me cilën fjalë lidhet fjala (një) shtëpi? Çfarë pyetjeje i përgjigjet fjala (një) shtëpi? Si quhet rasa që gjendet me pyetjen çfarë? Po fjala *informacion* me çfarë pyetje gjendet? Në çfarë rase është fjala *informacion*? Çfarë tregojnë emrat (një) shtëpi, *informacion* në kallëzore? Nga se paraprihet emri *qendër*? Në çfarë rase është emri *qendër*? Çfarë tregon emri *qendër* në kallëzore me parafjalën *në*? Çfarë tregojnë emrat *dhoma, kuzhinë, çmim, numrin* në kallëzore me parafjalët *me, në*?

- u kërkon të gjejnë emrin në kallëzore pa parafjalë në lajmërimin e dytë. Pyet: Me cilën fjalë lidhet? Çfarë tregon emri *apartment* në kallëzore pa parafjalë? U kërkon të gjejnë emrat në kallëzore me parafjalë në lajmërimin e dytë. Bën pyetjet: Me çfarë parafjalësh janë ndërtuar? Çfarë tregojnë emrat *pallat, qendër, kat, drejtim, numër* në kallëzore me parafjalët *në, me*?

- nxjerrin përfundimet që emri në rasën kallëzore lidhet vetëm me folje, që rasa kallëzore gjendet me pyetjet: *kë, cilin, çfarë*, që ajo përdoret me dhe pa parafjalë, që rasa kallëzore pa parafjalë, tregon sendin mbi të cilin bie drejtpërdrejt veprimi i foljes, po tregon edhe kohë, sasi, masë etj.; që parafjalë të rasës kallëzore janë: *në, me, pa, për, më, mbi, nën, nëpër*; që rasa kallëzore me parafjalë tregon: *vend, kohë, sasi, masë, mjet* etj.;

- u kërkon të vështrojnë tabelat e lakimit të emrave në kallëzore dhe u bën pyetjet: Në çfarë trajte janë emrat? Në çfarë numri? Çfarë mbaresash kanë në kallëzore të pashquar emrat e gjinisë mashkullore e femërore në njëjës? Çfarë mbaresash kanë në kallëzore të pashquar emrat e gjinisë mashkullore e femërore në shumës? Emrat e cilës gjini dalin njësoj në emërore dhe kallëzore të pashquar njëjës e shumës?

- nxjerrin përfundimin për sistemin e mbaresave të gjinoreve së emrave të pashquar mashkullore e femërore. Përsëritet e njëjta procedurë për trajtën e shquar mbi bazën e analizës së tabelës përkatëse dhe pyetjeve që e pasojnë;

- u kërkon të vështrojnë ilustrimin përkatës për përdorimin dhe funksionet e kallëzores. U kërkon që në bazë të ilustrimit të shkruajnë çfarë kanë mësuar për kallëzoren (Si përdoret kallëzorja, *me* apo *pa* parafjalë? Çfarë funksionesh kryen kallëzorja *pa* parafjalë? Me çfarë parafjalësh përdoret kallëzorja? Çfarë tregon kallëzorja me parafjalë?

Ora e dytë

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për rasën gjinore.

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-4, fq. 54. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësuësit:

Kundrinori i drejtë

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit kundrinorin e drejtë, të njohin veçoritë e ndërtimit të tij dhe ta përdorin drejt në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë fjalitë në fillim të mësimit nr. 25: *Drejtorja e shkollës vuri një lajmërim. Shpendi e lexoi lajmërimin me kënaqësi. Shkolla do të organizonte krosin e pranverës.* dhe u kërkon të thonë, nëse janë të thjeshta apo të përbëra dhe të sjellin argumentet përkatëse. U kërkon të gjejnë kryefjalët dhe kallëzuesit e tyre. Pastaj i pyet: Çfarë janë fjalët (*një*) lajmërim, lajmërimin, krosin? Me cilën fjalë lidhen? Me çfarë pyetjesh gjenden? Në çfarë rase janë? Çfarë tregojnë emrat në rasën kallëzore (*një*) lajmërim, lajmërimin, krosin? Si quhen fjalët që tregojnë sendin mbi të cilin bie veprimi i foljes? A mund të hiqen kundrinorët e drejtë (*një*) lajmërim, lajmërimin, krosin?;

- nxjerrin përfundimin që kundrinori i drejtë tregon sende mbi të cilat bie veprimi i foljes, që për të gjetur kundrinorin e drejtë bëjmë pyetjet: *kë?*, *cilin?* *çfarë?* drejtuar foljes, që kundrinori i drejtë nuk mund të hiqet, është plotës *kryesor* i foljes;

- u kërkon të lexojnë fjalitë *Mësuesi vuri një lajmërim tek dera e klasës. Shpendi e lexoi atë me kujdes. Zana e pyeti për përmbajtjen e lajmërimin.* dhe bën pyetjet: Me cilat fjalë lidhen fjalët me ngjyrë blu? Me çfarë pyetjesh gjenden? Për se shërbejnë fjalët me ngjyrë blu? Çfarë janë fjalët me ngjyrë blu?;

- nxjerrin përfundimin që kundrinori i drejtë mund të jetë: një *emër* ose një *përemër* në rasën kallëzore, një *trajtë e shkurtër* e përemrit vetor në rasën kallëzore;

- u kërkon të shohin me kujdes skemat që vijojnë dhe i pyet: Çfarë janë kundrinorët e përdorur, *emra*, *përemra*, *trajta të shkurtra*?

Ora e dytë

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-5, fq. 55, 56. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësuesit:

Tregimi

Synimi: të njohin nxënësit veçoritë e tekstit tregues dhe të ndërtojnë vetë tekste treguese duke u mbështetur në tekstet treguese të analizuara në klasë.

Ora e parë

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- i fton nxënësit që të lexojnë tekstin „*Një ndodhi në klasë*“ në fq. 98 të *Librit të nxënësit*;
- pasi diskutojnë për fjalët e vështira, bën pyetjet: Çfarë është ky tekst, *një lajmërim, një përshkrim, një tregim*? Për se flitet në këtë tekst? Kush i tregon ngjarjet e këtij teksti? Si e ka nisur shkrimtari tregimin e tij? Si e vazhdon tregimin, çfarë paraqet, pra pas hyrjes? U kërkon të renditin ngjarjet e paraqitura dhe të thonë se si përfundon teksti;
- nxjerrin përfundimin që tregimi paraqet ngjarje nga jeta e një personazhi, nga jeta e një familjeje ose e një populli, që tregimi ka : *hyrjen*, ku paraqitet vendi dhe koha ku zhvillohen ngjarjet dhe personazhet, *zhvillimin*, ku jepet një ngjarje ose një personazh që prish situatën fillestare dhe zhvillimi i ngjarjeve dhe, së fundi, *mbylljen*, që paraqet përfundimin e ngjarjeve pas prishjes së situatës fillestare;
- u kërkon të lexojnë tekstin në vazhdim “*Ulliri*” (fq. 99) dhe pyet : Ku dallohen dy tekstet e mësipërme? Kërkon ta argumentojnë. Vazhdon me pyetjet: Në cilin tekst tregohet diçka? Në cilin tekst përshkruhet diçka? Cilat janë karakteristikat e përshkrimit? Cilat janë karakteristikat e tregimit?;
- nxjerrin përfundimet që në dallim nga përshkrimi, që paraqet tiparet fizike ose shpirtërore të një njeriu, karakteristikat e një kafshe, të një objekti, të një ambienti, tregimi paraqet ngjarje nga jeta e një personazhi, nga jeta e një familjeje ose e një populli.

Ora e dytë

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për tregimin.

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-5, fq. 57, 58. Gjatë 15-20 minutave bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtje: Mësues-i/ja, nëse e sheh të nevojshme, mund të përdorë edhe një orë tjetër mësimi për këtë temë. Ndarja e mësimave në orë mësimi, nuk është e detyrueshme për mësues-in/en.

Vërejtjet e mësuesit:

Dhanorja

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit rasën dhanore të emrave dhe funksionet e saj dhe ta përdorin drejt atë në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë pjesën e tekstit në fillim të mësimi nr. 27. Bën pyetjet: Çfarë janë fjalët me shkronja blu (bastunit, Zefit)? Çfarë pyetjeje i përgjigjen? Në çfarë rase janë emrat që u përgjigjen pyetjeve *kujt, cilit?*;

- nxjerrin përfundimin që rasa dhanore gjendet me pyetjet: *kujt? cilit?*

- u kërkon të lexojnë fjalitë që vijojnë: *Zefit i erdhën urime nga mbarë Mali i Zi për veprimin e tij. Të gjithë i hodhën një vështrim shokut të klasës. Zefit nuk i rrihej në klasë nga gëzimi.* (dhe u kërkon të vështrojnë emrat në dhanore). Pyet: A kanë të njëjtin kuptim emrat në dhanore? Në cilën fjali, emri në dhanore tregon një qenie të cilit i drejtohet veprimi i foljes? Në cilën fjali, emri në dhanore tregon personin të cilit i përket diçka? Në cilën fjali, emri në dhanore tregon personin që përjeton një gjendje të caktuar?;

- nxjerrin përfundimet që emri në rasën dhanore tregon sendin a personin të cilit i drejtohet veprimi i foljes, sendin a personin që përjeton ose të cilit i përket diçka;

- u kërkon të vështrojnë tabelat e lakimit të emrave në dhanore dhe u bën pyetjet: Në çfarë trajte janë emrat? Në çfarë numri? Çfarë mbaresash kanë në dhanore *të pashquar* emrat e gjinisë mashkullore e femërore në njëjës? Çfarë mbaresash kanë në dhanore *të pashquar* emrat e gjinisë mashkullore e femërore në shumës?

- nxjerrin përfundimin për sistemin e mbaresave të dhanores së emrave të pashquar mashkullore e femërore. Përsëritet e njëjta procedurë për trajtën e shquar, mbi bazën e analizës së tabelës përkatëse dhe pyetjeve që vijojnë;

- u kërkon të vështrojnë ilustrimin përkatës për përdorimin dhe funksionet e dhanores. U kërkon që në bazë të ilustrimit të shkruajnë si përdoret dhanorja, me apo pa parafjalë, çfarë funksionesh kryen etj.

Ora e dytë

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për rasën dhanore.

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-5, fq. 59. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësuesit:

Rrjedhorja

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit rasën rrjedhore të emrave dhe funksionet e saj dhe ta përdorin drejt atë në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë pjesën “*Në shtëpinë e Zefit*” në fq. 104 të *Librit të nxënësit*. Bën pyetjet: Për se flitet në këtë tekst? Çfarë janë fjalët *gëzimi, qelqi, frutash molle*? Cilat fjalë përcaktojnë? Në çfarë rase janë?;

- nxjerrin përfundimin që emrat në rasën rrjedhore pa parafjalë përdoren më shpesh si përcaktorë të emrit;

- u kërkon të lexojnë fjalitë që vijojnë: *Ata po plasnin vapës. Nxënësit ecnin rrugëve duke kënduar. Zakonisht verës ata bëjnë shëtitje tek njeri-tjetri*. Pyet: Çfarë janë fjalët *vapës, rrugëve, verës*? Në çfarë rase janë emrat *vapës, rrugëve, verës*? Me cilat fjalë lidhen? Çfarë tregojnë?;

- nxjerrin përfundimin që emri në rasën rrjedhore ka kuptime të ndryshme, mund të tregojë shkak, vend, kohë etj.;

- u kërkon të lexojnë fjalitë në vazhdim: *Nxënësit u ulën skaj shokëve të tyre. Pas disa çastesh erdhi edhe mësuesja. Ata thanë se e kishin gjetur shtëpinë pa kurrfarë vështirësie*. Dhe u bën pyetjet: Me cilat fjalë lidhen fjalët *skaj shokut të tyre, pas disa çastesh, pa kurrfarë vështirësie*? Çfarë tregojnë ato? Si janë ndërtuar rrethanorët *skaj shokut të tyre, pas disa çastesh, pa kurrfarë vështirësie*? Në çfarë rase janë emrat *shokut, çastesh, vështirësie*?;

- Nxjerrin përfundimet që rrjedhorja me parafjalë mund të tregojë: *vend, kohë, sasi, lëndë, tipar, pjesë, shkak* etj.;

- vështrojnë tabelën që vijon, me fjali me emra në rasën rrjedhore me parafjalë. Bën pyetjet: Çfarë kanë përpara emrat *nxënës, shokë, muaj, dorë, fëmijë*? Në çfarë rase janë ato? Çfarë tregojnë emrat në rrjedhore të paraprirë nga parafjalët *prej, për, para*? U kërkon të plotësojnë tabelën, duke shënuar çfarë tregojnë rrjedhoret me parafjalë;

- u kërkon të vështrojnë tabelën e lakimit të emrave në rrjedhore dhe u bën pyetjet: Në çfarë trajte janë emrat? Në çfarë numri? Çfarë mbaresash kanë në dhanore të pashquar emrat e gjinisë mashkullore e femërore në njëjës? Çfarë mbaresash kanë në dhanore të pashquar emrat e gjinisë mashkullore e femërore në shumës?;

- nxjerrin përfundimin për sistemin e mbaresave të rrjedhores së emrave të pashquar mashkullore e femërore. Përsëritet e njëjta procedurë për trajtën e shquar mbi bazën e analizës së tabelës përkatëse dhe pyetjeve që e vijojnë;

- u kërkon të vështrojnë ilustrimin përkatës për përdorimin dhe funksionet e rrjedhores. U kërkon që në bazë të ilustrimit të shkruajnë si përdoret dhanorja, me apo pa parafjalë, çfarë funksionesh kryen rrjedhorja me dhe pa parafjalë etj.

Ora e dytë

Synimi: të zbatojnë nxënësit gjithçka që është mësuar për rasën dhanore.

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-5, fq. 60. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësuesit:

Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit kundrinorin e zhdrejtë pa parafjalë, të njohin veçoritë e ndërtimit të tij dhe ta përdorin drejt në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë pjesën në fillim të mësimi nr. 29: *Nesti shikoi me inat shokun e ri. I hodhi një shikim bastunit të tij. Njëri qeshi. Zefit i ra në vesh fjala “çalaman”?* *Atij i erdhi për të qarë.* dhe u kërkon të thonë, nëse fjalitë janë të thjeshta apo të përbëra dhe të argumentojnë përgjigjen. U kërkon të gjejnë kryefjalët dhe kallëzuesit e tyre. Pastaj i pyet: Çfarë janë fjalët *bastunit, Zefit, atij*? Me cilën fjalë lidhen? Me çfarë pyetje gjenden? Në çfarë rase janë? Çfarë tregojnë emrat dhe përemrat *bastunit, Zefit, atij* në rasën dhanore? Si quhen emrat ose përemrat në rasën dhanore që lidhen me foljen? A mund të hiqen kundrinorët e zhdrejtë *bastunit, Zefit, atij*?

- nxjerrin përfundimin që kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë tregon personin a sendin të cilit i drejtohet veprimi i foljes, që kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë është një *emër* ose *përemër* në rasën dhanore dhe u përgjigjet pyetjeve *kujt, cilit*, që ai nuk mund të hiqet, është, pra, *plotës* kryesor i foljes.

- u kërkon të lexojnë fjalitë: *Mësuesja u foli fëmijëve. Zefit i ka ndodhur një fatkeqësi. Atyre u erdhi keq për Zefin.* dhe bën pyetjet: Çfarë janë fjalët *fëmijëve, Zefit, atyre*? Çfarë janë fjalët *u, i, u*? Cilat fjalë përsërisin? Me cilat fjalë lidhen fjalët me ngjyrë blu? Me çfarë pyetje gjenden? Për se shërbejnë fjalët me ngjyrë blu? Çfarë janë fjalët me ngjyrë blu?

- nxjerrin përfundimin që kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë mund të jetë: një emër ose përemër në rasën dhanore pa parafjalë, që shoqërohet gjithmonë nga trajta e shkurtër e përemrit vetor.

- u kërkon ta verifikojnë e përforcojnë përfundimin e arritur përmes analizës së tabelës që vijon.

Ora e dytë

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-6, fq. 61, 62. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësuesit:

Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë të dallojnë nxënësit kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë, të njohin veçoritë e ndërtimit të tij dhe ta përdorin drejt në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë pjesën: *Atë natë unë ndeja deri vonë me Zefin. Bisedova gjatë me të për aksidentin e tij. Ana shkoi me shoqet. Ajo do të bisedonte me ta për detyrat e nesërme.*, në fq. 108 të *Librit të nxënësit* dhe u kërkon të thonë, nëse fjalitë janë të thjeshta apo të përbëra dhe të argumentojnë përgjigjen. U kërkon të gjejnë kryefjalët dhe kallëzuesit e tyre. Pastaj i pyet: Çfarë janë fjalët: *me Zefin, me të, për aksidentin, me shoqet, me ta, për detyrat?* Në çfarë rase janë emrat dhe përemrat e paraprirë nga parafjalët *me, për?* Me cilën fjalë lidhen? Me çfarë pyetjesh gjenden? Si quhen emrat ose përemrat *me parafjalë* që lidhen me foljen? A mund të hiqen kundrinorët e zhdrejtë me parafjalë *me Zefin, me të, për aksidentin, me shoqet, me ta, për detyrat?*;

- nxjerrin përfundimin që kundrinori i zhdrejtë me parafjalë është një *emër* ose *përemër* në rasën *kallëzore* me parafjalë, që kundrinori i zhdrejtë me parafjalë plotëson më mirë kuptimin e foljes, po nuk është plotës kryesor, që ai mund të hiqet dhe u përgjigjet pyetjeve me përemër të paraprirë nga një parafjalë;

- u kërkon të lexojnë fjalitë: *Nesti e tërhoqi fshehtas shokun nga mënga. Ana e zëmëruar, shkoi me shpejtësi drejt Nestit.* dhe bën pyetjet: Çfarë janë fjalët nga mënga, ndaj Nestit? Me cilat fjalë lidhen fjalët nga mënga, drejt Nestit? Me çfarë pyetje gjenden? Për se shërbejnë? Çfarë janë?

- nxjerrin përfundimin që kundrinor i zhdrejtë me parafjalë mund të jetë edhe një emër ose përemër në rasën emërore dhe rrjedhore me parafjalë.

- u kërkon të vështrojnë tabelën që pason dhe i pyet: Si janë ndërtuar kundrinorët e zhdrejtë me parafjalë? Në çfarë rase janë emrat kundrinorë të zhdrejtë me parafjalë? Me cilat fjalë lidhen?

Ora e dytë

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-6, fq. 63, 64. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësuesit:

Gjuha zyrtare

Ora e parë: parashtrim i njohurive të reja

Synimi: të mësojnë nxënësit, se në Mal të Zi gjuhë zyrtare është serbishtja ijekavike e alfabetit cirilik dhe latin dhe se në komunat, ku pakica kombëtare shqipfolëse bën shumicën, gjuhë në përdorim zyrtar është edhe shqipja.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë tabelat e shkruara në një dhe dy gjuhë në fq. 111 të *Librit të nxënësit*. Bën pyetjet: Në çfarë gjuhe janë shkruar tabelat? Pse disa tabela janë shkruar vetëm në një gjuhë? Pse disa të tjera janë shkruar në dy gjuhë? Cila është gjuha zyrtare në Mal të Zi? Ku përdoret serbishtja si gjuhë zyrtare? Ku është në përdorim zyrtar gjuha shqipe?

- arrijnë në përfundimin që në Mal të Zi gjuhë zyrtare është serbishtja ijekavike e alfabetit cirilik dhe latin dhe në komunat, ku pakica kombëtare shqipfolëse bën shumicën, gjuhë në përdorim zyrtar është edhe shqipja. Serbishtja përdoret si gjuhë zyrtare, me gojë dhe me shkrim, në mbarë territorin e Malit të Zi në marrëdhëniet shtetërore, në zyra, në shkolla në shtyp etj. dhe që shqipja është në përdorim zyrtar, me gojë dhe me shkrim, në shkolla e në shtyp, në territoret me shumicë të popullsisë shqiptare në Mal të Zi.

- u kërkon të lexojnë dy variantet e tekstit „Gështenjapjekësi“ dhe të krahasojnë gjuhën e tyre. Bën pyetjet: Përse në tekstin e parë thuhet “*Gështenjapjekësi*”, “*E shihja ...*” kurse në të dytin “*Gështejpjekësi*”, “*E shifja ...*”? Çfarë ndryshimesh të tjera venë re në gjuhën e dy teksteve? Cili ju duket më i afërt me gjuhën e përdorur në televizion, në libra dhe në revista?

- nxjerrin përfundimet që *gjuhë letrare* është ajo që mësohet në shkollë dhe përdoret në libra, gazeta, revista, radio, televizion, në shkencë, kulturë etj., që gjuha shqipe ka dy dialekte: *gegërishten* ose dialektin e Veriut dhe *toskërishten* ose dialektin e Jugut.

- u kërkon të vështrojnë tabelën me të dhëna për veçoritë e dy dialekteve të shqipes, gegërishtes dhe toskërishtes dhe bën pyetjet: A ka ndryshime ndërmjet gegërishtes dhe toskërishtes? Çfarë ndryshimesh venë re ndërmjet tyre? Po ndërmjet gjuhës letrare dhe toskërishtes a ka dallime? Me cilin dialekt afrohet gjuha letrare?

- nxjerrin përfundimet që dallimet ndërmjet dy dialekteve të shqipes nuk janë të mëdha dhe vihen re në aspektin tingullor të gjuhës, që gjuha letrare shqipe është më afër me toskërishten, që duke përdorur gjuhën letrare, njerëzit merren vesh më lehtë dhe më mirë me njëri-tjetrin.

Ora e dytë

Materialet që do të përdoren: Fletorja e punës

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon përgjigje individuale, në çifte ose në grupe, sipas rastit, për kërkesat e ushtrimeve 1-5, fq. 65. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësuesit:

1. Biseda telefonike

1.

a) zyrtare; b)

A.

a) b) përmendjes së emërtimeve të institucioneve. c)

B.

a) nga mënyra e prezantimit. b) c)

2. Anketa

1.

a) Anketa kërkon të përcaktojme librat që na pëlqejnë;

b) U drejtohet djemve dhe vajzave të një klase;



c) Kërkon të tregojnë se cilat lloj librash u pëlqejnë më shumë, ato me poezi, me tregime, romanet apo librat fantastiko-shkencorë;

ç) Ka dy lloj pyetjesh, nëse janë vajza ose djem dhe cili lloj librash u pëlqen.

3.

a) pyetje b) tabela, tekste, diagrame.

4.

**3. Reklama**

1. a) 1) 2) 3) shtypi b) 1) cilësia 2) 3) c) prodhuesi i saj; ç) nga përmbajtja e reklamës;
 d) ruajtja e mjedisit jetësor; dh) pamore, gjuhësore; e) me fjalën "Ushqyese".

2. a) e konsumatorëve, një malli, prodhimi; b) televizive, të shtypit; c) zanore, pamore, përdorimin specifik; ç) televizive.

4. Fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme

1. a) formën; b) emrat, mbiemrat, përemrat, foljet; c) nuk e ndryshojnë; ç) ndajfoljet, lidhëzat, pasthirrmat.

2. e pandryshueshme, tri

3.

	të ndryshueshme	të pandryshueshme
emrat	+	
ndajfoljet		+
foljet	+	
numërorët	+	
parafjalët		+
përemrat	+	
pasthirrmat		+
lidhëzat		+
mbiemrat	+	
pjesëzat		+

4.

fjalët e ndryshueshme	fjalët e pandryshueshme
arkeologët	me
kanë gjetur	mjaft
figura	me
të shoqëruara	në
mbishkrime	
muret	
e ndërtesave	
të Pompeit	

5.

fjalët e ndryshueshme	fjalët e pandryshueshme
televizioni	sot
është bërë	më
mjeti	meqenëse
i rëndësishëm	nga
i reklamave	një
ndiqet	shumë
publik	
i gjerë	

5. Struktura dhe familja e fjalës

1. a) rrënja b) parashtesa c) prapashtesa

2. a) të thjeshta, të prejardhura dhe të përbëra b) parashtesa, prapashtesa c) fjalëve, të përbëra

3.

fjalët	rrënja	ndajshtesa
mbledh	mbledh	-
mbledhje	mbledh	-je
përmbledh	mbledh	për-
mbledhës	mbledh	-ës
i përmbledhur	mbledh	për-, -ur

4.

rrënja e fjalës	ndajshtesa	fjala e re
dor(ë)	për-	përdor
dor(ë)	-zo	dorëzohj
dor(ë)	-ac	dorac-
dor(ë)	-ëz	dorezë

5.

rrënja e fjalës	ndajshtesa	fjala e re
përdor	-ues	përdorues
përdor	-im	përdorim
përdor	-shëm	i përdorshëm
përdor	-ur	i përdorur

6.

shkruaj	përshkruaj
shkrim	përshkrim
shkrimtar	nënshkruaj
shkrimtaruc	nënshkrim
dorëshkrim	

7.

argjendar, centralist, dritare, peshkatar, akullorë, frikacak

8.

para shtesa	dituri	njohje	drejtësi	plotësim	bindje	qartësi
pa	padituri	-	padrejtësi	-	-	paqartësi
mos	-	mosnjohje	-	mosplotësim	mosbindje	-

9.

prapashtesa	emri i atij që kryen një punë				
	blerë	faj	sport	argjend	arsim
-(ë) s	+				
-ar, -tar				+	+
-ist			+		
-tor		+			

10. a) e përbërë b) hotel, restorant c) vizë lidhëse

11.

fjalët	të prejardhura	të përbëra
lulëkuqe		+
bashkathetar		+
argjendar	+	
akullore	+	
këmbëzbathur		+
pagjumësi,	+	
bashkëveprim		+
përqindje,	+	
përballoj	+	
copë-copë		+

12.



13.

+	çorganizoj	_____
—	çvulos	zhvulos _____
—	çqep	shqep _____
—	çthur	shthur _____
—	çdredh	zhdredh _____
+	çorjentoj	_____

6. Përshkrimi

1.

futboll	↗ ↘ ↙ ↚ ↛ ↜ ↝ ↞ ↠ ↡ ↢ ↣ ↤ ↥ ↦ ↧ ↨ ↩ ↪ ↫ ↬ ↭ ↮ ↯ ↰ ↱ ↲ ↳ ↴ ↵ ↶ ↷ ↸ ↹ ↺ ↻ ↼ ↽ ↾ ↿ ↺ ↻ ↼ ↽ ↾ ↿ ↺ ↻ ↼ ↽ ↾ ↿	lojë me raketa e top sipër rrjete
boks		lojë me një top a disk gome, që lojtarët e gjuajnë me një shkop për në portë
volejboll		lojë me top në ujë, me nga 7 lojtarë për ekip
hokej		lojë me top mbi rrjetë me nga 6 lojtarë në ekip
tenis		ndeshje që zhvillohet nga dy lojtarë në ring
vaterpolo		lojë që luhet në një fushë nga dy skuadra të cilat kanë nga 11 lojtarë
shah	↗ ↘ ↙ ↚ ↛ ↜ ↝ ↞ ↠ ↡ ↢ ↣ ↤ ↥ ↦ ↧ ↨ ↩ ↪ ↫ ↬ ↭ ↮ ↯ ↰ ↱ ↲ ↳ ↴ ↵ ↶ ↷ ↸ ↹ ↺ ↻ ↼ ↽ ↾ ↿ ↺ ↻ ↼ ↽ ↾ ↿ ↺ ↻ ↼ ↽ ↾ ↿	lojë që luhet duke goditur topin e pingpongut me raketë
pingpong		lojë që luhet midis dy vetëve në një tabelë të ndarë në katrorë

2.

- ___ 1 ___ Loja “nëntësh” luhet në një karton (fibër plastmasi), në të cilin janë vizatuar tre katrorë bashkëqendrorë dhe katër vija që bashkojnë meset e brinjëve paralele.
- ___ 2 ___ Në këtë lojë marrin pjesë dy lojtarë.
- ___ 3 ___ Çdo lojtar ka nëntë gurë me ngjyra të ndryshme, që duhet t’i vendosë për të formuar një treshe në anët e katrorëve ose në vijat e ndërmjetme.
- ___ 4 ___ Lojën e hap lojtari A. Ai vë një gur. Pastaj vendos një gur lojtari B.
- ___ 5 ___ Ai mundohet ta pengojë lojtarin A të formojë një rresht me tre gurë dhe përpiket të krijojë një treshe me gurët e vet.

- ___ 6 ___ Nëse një lojtar arrin të formojë një treshe (me gurët e tij), ai ka të drejtë të marrë një gur nga kundërshtari.
- ___ 7 ___ Ai që realizon më shumë treshe dhe që merr më shumë gurë, fiton lojën.

3. Në lojën e shahut marrin pjesë dy lojtarë. Loja e shahut luhet mbi një tabelë që ka 64 fusha, 32 të bardha dhe 32 të zeza. Tabela vendoset në mënyrë që në këndin e djathtë të çdo lojtari të jetë fusha e bardhë. Figurat ose gurët e shahut janë: mbreti, dama ose mbretëresha, dy kala, dy oficerë, dy kuaj dhe tetë ushtarë për secilin lojtar. Lojën e fillon lojtari me figura të bardha, ndërsa pastaj lëvizjet i bëjnë të alternuara sipas rregullave të caktuara. Ndeshjen e fiton lojtari që e zë mat mbretin e kundërshtarit ose kur lojtari e ndërpret lojën dhe deklaron se dorëzohet. Ndeshja që përfundon në barazim quhet remi.

4. Basketbolli zhvillohet midis dy ekipeve që kanë secili nga 12 lojtarë. Prej tyre marrin pjesë në lojë vetëm nga pesë lojtarë për secilën skuadër. Loja ka katër sete me nga 10 minuta lojë secili. Lejohet ndërrimi i pakufizuar i lojtarëve. Qëllimi është që topi të futet në koshin e kundërshtarit. Çdo shënim koshi gjatë lojës sjell dy pikë. Koshi që shënohet përtej 6,25 m. sjell tre pikë, ndërsa shënimi i gjuajtjeve të lira, një pikë.

Basketbollin e ka shpikur Xhejms Nejsmith, me origjinë kanadeze, në vitin 1891, kur dimri i ftohtë në Springfield (në SHBA) i pengonte nxënësit e një shkolle që të merren jashtë me ndonjë sport.

Ndeshja e parë është luajtur me ekipe që kishin nga dhjetë lojtarë, me top futbollit dhe me dy shporta për mbledhjen e frutave në vend të koshave të sotëm.

Ndeshja e parë ndërkombëtare në Evropë është luajtur në vitin 1919 ndërmjet ekipit të Francës dhe të Italisë. Në Mal të Zi loja është futur për herë të parë në vitin 1923 nga amerikani Uilljam Vilandi, por ka marrë zhvillim pas Luftës së Dytë Botërore. Basketbolli u fut për herë të parë në lojërat olimpikë në vitin 1936, në Lojërat Olimpikë të Berlinit.

5. qëllimi; historia; numri i lojtarëve; pjesët e lojës.

6. qëllimi; numri i lojtarëve; pjesët e lojës; ku luhet; si luhet;

7. a. Zinedin Zidan; b. futboll; c.

7. Sinonimet, antonimet dhe homonimet

1. a) sinonime; b) antonime; c) homonime,

2.

fjalët	sin.	ant.	hom.
verë (stinë), verë (pije)			+
trim, guximtar, burrë	+		
ngjitem, zbres		+	
rrugë, udhë	+		
i lodhur, i palodhur, i çlodhur		+	
përvojë, eksperiencë	+		
jashtë, brenda,		+	
i ëmbël, i hidhur		+	
pres(shokun), pres(mishin)			+

3.

a) shoh-shikoj-vështroj-vërej-këqyr; dëftej-kallëzohj-rrëfejt; b) lidh-zgjidh; afrohem-largohem.

4.

a) dashuri-urrejtje;
b) (kam shumë) mall-(bleva shumë) mall; pres (me thikë)-(kam një orë që) pres.

5.

greminë-humnerë	prapa-pas
i rëndë- i vështirë	i ashpër- i egër
mbaroj - përfundoj	i shkathët – i hedhur
lajmëroj- njoftoj	rrugë -udhë
ngre- çoj	kurriz- shpinë

6.

a) brenda; b) ulem; c) zbraz; ç) i robëruar; d) hidhërim; dh) i butë;
e) zhvesh; ë) zbuloj.

8. Ndryshimi i emrave

1.

a) rasa; b) emërore, gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore; c) lakim.

2.

rasa	pyetjet
emërore:	kush? cili? cila? cilët? cilat? ç'? çfarë?
gjinore:	i (e) kujt? i (e) cilit? i (e) cilës? i (e) cilëve? i (e) cilave?
dhanore:	kujt? cilit? cilës? cilëve? cilave?
kallëzore:	kë? cilin? cilën? cilët? cilat? ç'? çfarë?
rrjedhore:	prej kujt? prej cilit? prej cilës? prej cilëve? prej cilave?

3.

emri	rrënja	mbaresa
klasës	klasë	-s
drita	drit	-a
murit	mur	-it
dera	der	-a
fletët	flet	-ët
lapsin	laps	-in
bankën	bank	-ën

4.

fjalitë	pyetja
Boksi është kryesisht sport i burrave.	kush?
Qëllimi i boksit është të hedhë për tokë kundërshtarit.	i kujt?
Boksit nuk i dihet origjina e vërtetë.	kujt ?
Jo të gjithë e pëlqejnë boksit.	kë?
Gjoni ka mbetur në dyshek prej boksit.	prej kujt?

emri	rasa	trajta	gjinia	numri
kopshti	emërore	e shquar	mashkullore	njëjës
zogj	kallëzore	e pashquar	mashkullore	shumës
e zogjve	gjinore	e pashquar	mashkullore	shumës
zogjsh	rrjedhore	e pashquar	mashkullore	shumës
zogjtë	emërore	e shquar	mashkullore	shumës
zogu	emërore	e shquar	mashkullore	njëjës

6.

emri	rasa
i librit	gjinore
shkrimtari	emërore
tregim	kallëzore
këngëtari	emërore
këngët	emërore
cilësitë	kallëzore
trimërinë	kallëzore
armikut	dhanore
e vendit	gjinore

7.

emërore	gjinore	dhanore	kallëzore	rrjedhore
luani	e dëshpërimit	luanit	kulmin	kafshëve
dhelpra	i kafshëve	gomarit	lajm	
gjahu	e takimit		miqësi	
gomari			gomarin	
mbreti			vendin	
gryka			frikë	
			gomar	
			luanin	
			sheshin	

9. Ndryshimi dhe shkallët e mbiemrave

1.

në gjini, në numër, në rasë

2.

mbiemri	gjinia	numri	rasa
olimpike	femërore	shumës	kallëzore
shqiptar	mashkullore	njëjës	emërore
e artë	femërore	njëjës	kallëzore
botëror	mashkullore	njëjës	kallëzore
e lirë	mashkullore	njëjës	kallëzore

3.

mbiemri	shkalla
i hijshëm	pohore
fisnik	pohore
madhështor	pohore
hundëshkabë	pohore
sypetrit	pohore
të gjatë	pohore
të dredhur	pohore
i veshur	pohore
i armatosur	pohore
e gjallë	pohore
e ngrirë	pohore
e papritur	pohore
më i ri	krahasore
më i bukur	krahasore
më i lartë	krahasore

10. Numërorët

1.

a) numërorë; b) mbiemra.

2.

a) b) c) kanë shkuar djem dhe vajza

3.

të dyja; të katërve; të tria; të pestët.

4.

pesëdhjetë, gjashtë mijë, gjashtë mijë e pesëqind, tetëqind, një mijë e pesëqind, katër mijë, pesëqind, tetë mijë e shtatëqind, dy mijë, tri mijë

Test për kontrollin e njohurive (kapitujt 1-3)

1.

a) b) jozyrtare

3.

A. a) b) porositësi i reklamës e ka bërë me qëllim c)

B. që të tërheqë vëmendjen e lexuesve

Futbolli	
Qëllimi	Historia
Të shënojnë gol në portën e skuadrës kundërshtare.	Historia e futbollit fillon në vitin 1863 në Angli, kur u krijua Federata e Futbollit të Anglisë.
Numri i lojtarëve	Pjesët e lojës
Në cilën skuadër ka njëmbëdhjetë lojtarë.	Loja ka dy pjesë, secila nga dyzet e pesë minuta. Ndërmjet tyre bëhet një pushim prej pesëmbëdhjetë minutash

5.

B. a) shtatë, një, çdo, na, në;

b) arsye, për të ngrënë, kos, ditë, rregullon, tretjen, qetëson, stomakun, ruan, peshën, forcon, muskujt, siguron, rritjen, forcon, kockat, kënaq, tavolinë

6.

mbiemri	shkalla krahasore	shkalla sipërore
i mirë	më i mirë	shumë i mirë
i keq	më i keq	shumë i keq
i shpejtë	më i shpejtë	shumë i shpejtë
i shkathët	më i shkathët	shumë i shkathët
i lehtë	më i lehtë	shumë i lehtë
i rëndë	më i rëndë	shumë i rëndë
i bukur	më i bukur	shumë i bukur

7.

a) ujit, ujitje, ujqor; b) ujësjellës, ujëvarë.

8.

shtëpi-ndërtesë;
 lëkundje-tronditje;
 i bukur-i shkëlqyer;
 fshat-katund;
 hap-çel;
 dridhje-luhatje.

9.

flas;
 zhvesh;
 humbje;
 afrojt;
 ngjitem.

10.

matematikë;
 veprimtari;
 stinë;
 pije.

11.

emri	rasa
atletika	emërore
sporti	kallëzore
botë	kallëzore
atletët	emërore
Greqinë	kallëzore
respektin	kallëzore
antikitet	kallëzore
atletikë	kallëzore
vrapimet	emërore
hedhja	gjinore
e diskut	

12.

mbiemrat	rasa	numërorët
interesante	kallëzore	dy mijë e pesëqind
olimpike	kallëzore	pesëmbëdhjetë
dimërore	kallëzore	gjashtëqind e pesëdhjetë
e kaluar	kallëzore	pesëmbëdhjetë
të mirënjohur	emërore	një mijë
të shquar	emërore	një milion
më të mëdha	gjinore	
më të rëndësishme	kallëzore	
olimpike,	kallëzore	
dimërore	kallëzore	
më të rëndësishme	gjinore	

11. Struktura e tekstit

1.

Hyrja:

Veshjet popullore shqiptare të Ulqinit, pavarësisht nga kontaktet e shumta kulturore që kanë pasur me kulturat e tjera, kanë ruajtur origjinalitetin e vet deri në ditët tona.

Zhvillimi:

Për punimin e veshjeve popullore përdoret leshi, pambuku dhe mëndafshi. Çdo shtëpi ka pasur dikur veg në të cilin endnin gratë. Përpos endjes, gratë qëndisnin, qepnin dhe thurnin...

Mbyllja

Ndryshimet në jetën shoqërore dhe ekonomike të popullsisë kanë sjellë ndryshimin gradual të veshjes. Ndërsa kostumet tradicionale të meshkujve pothuajse janë zhdukur, ato të femrave janë ruajtur, jo vetëm si dëshmi e trashëgimisë së kulturës popullore, por edhe si tregues i përkatësisë dhe origjinës familjare.

Përshtatur sipas faqes se internetit www.Ulqini.de

2.

1. Ruajtja e origjinalitetit të veshjeve;
2. Materialet që përdornin;
3. Veshja tradicionale e grave;
4. Veshja tradicionale e burrave;
5. Përdorimi i tyre sot.

12. Përemrat vetorë

1.

ti, mua, më, ty, të, ne, na, juve, ju, atij, i, atyre, u , atë , e.

2.

1. ata; 2. ju; 3. ata; 4. ne; 5. ata.

3.

1. atë; 2. ato; 3. ata; 4. ajo.

4.

1. ne; 2. ju; 3. atij; 4. asaj; 5. atyre; 6. atë; 7. ato.

	njëjës	shumës	njëjës	shumës
emërore	unë	ne	ti	ju
gjinore	-	-	-	-
dhanore	mua, më	neve, na	ty, të	juve, ju
kallëzore	mua, më	ne, na	ty, të	ju, ju
rrjedhore	(prej) meje	(prej) nesh	(prej) teje	(prej) jush

	mashk.	fem.	mashk.	fem.
emërore	ai	ajo	ata	ato
gjinore	i,e atij	i,e asaj	i,e atyre	i, e atyre
dhanore	atij, i	asaj, i	atyre, u	atyre, u
kallëzore	atë, e	atë, e	ata, i	ato, i
rrjedhore	(prej) atij	(prej) asaj	(prej) atyre	(prej) atyre

6.

1. ma; 2. ua; 3. jua; 4. m'i; 5. na i; 6. t'i; 7. ia; 8. na e; 9. jua.

13. Përcaktori dhe ndajshtimi

1.

e Bunës, druri, të mrekullueshme, për peshkim, e tyre, të jashtëzakonshme, e bukura, të Lindjes, së Largët, e plotë, të saj e zogjve, e valëve

2.

e ujit, e trekëndëshit, të rrjedhës, së lumit, e tij, i lumit, e tretë, e detit, e djathtë, të Bunës.

3.

Qyteti i Vjetër i sotëm, Mehmet Bushatliu, Hecquard

4.

Bunë; banorët e Ulqinit; qytet në breg të Adriatikut.

6.

të gjatë, detare, tregtare, qyteti, më të madh, e shtatëmbëdhjetë, të nëntëmbëdhjetë.

7.

1. ndajshtim i veçuar; 2. ndajshtim; 3. ndajshtim: 4. ndajshtim, ndajshtim.

14. E vërtetë apo legjendë

1.

nuk janë të vërteta

2.

a) përshkrimit të personazheve; b) ; c) .

3.

b) ; c) të zmadhuara.

4. a) gojëdhënë ose legjendë; b); c).

15. Fjalja e thjeshtë dhe e përbërë

1. a); b) të përbëra.

2. a); b); c) të përbëra.

3. Zanat vëzhgojnë Mujin, e pyesin për nënë e babë.; Hëna rri lart mbi kryet e tyre dhe i këqyr tek kuvendojnë.; Hija e shkëmbit zgjatet mbi gremina dhe në bjeshkë fryn flladi i natës.; Shushurijnë gjethet e aheve dhe gurgullojnë krojet e ftohta.

4. A.
Kali mori arratinë. Gjergji nxori menjëherë shpatën e mprehtë;
Ia ndau kryet nga trangu;
Tre vjet rresht vendi rreth e qark kundërmoi erë kërme...

- B.
Kali mori arratinë.; Gjergji nxori shpatën.; Ia ndau kryet nga trangu.

16. Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë

1. 1. Besniku i tha Vlerës: “Jam i kënaqur nga stërvitja jote”.
2. Vlera i premtoi Besnikut: “Do të stërvitem rregullisht çdo ditë”.
3. Vlera i tha Besnikut: “Një mijë pengesa sikur të më dalin përpara, do t’i kapërcej me guxim”.
2. 1. Besniku i tha Vlerës: “Jam i kënaqur nga stërvitja jote”.
2. “Jam i kënaqur nga stërvitja jote”, – i tha Besniku Vlerës.
3. “Jam i kënaqur, - i tha Besniku Vlerës, - nga stërvitja jote.”
3. Nëna u tha djemve: “Hyni brenda, se jeni bërë ujë.”
Ajo i pyeti fëmijët “Si shkoni me mësim?”
“Sa shokë do të vijnë?”, - e pyeti nëna.
4. 1. Babai tha: “Edhe në vështirësi njeriu s`duhet të bëhet zemërlepur”.
2. “Edhe në vështirësi njeriu s`duhet të bëhet zemërlepur”, - tha babai.
5. Ajo tha se Fishta ishte shkrimtari i saj i preferuar.
Dritani iu përgjigj se Genci s`do t`i linte në baltë.
Albani më tha se ishte penduar që s`kishte ardhur me ne.
Mësuesi na tha se, gjatë verës, duhej të lexonim sa më shumë libra.

17. Llojet e fjalise së thjeshtë

1. 1. dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore; 2. dëftore; 3. nxitëse; 4. pyetëse; 5. dëshirore; 6. emocion ose ndjenjë.
2. A. katërmbëdhjetë fjali B. a) nëntë dëftore; b) pesë pyetëse.
3. a) tri fjali nxitëse; b) katër dëshirore.
4. Sa është rritur Artani!; Sa e bukur qenka koha!; Erdhi babai?!; Luaj këmbët!

18. Kryefjala dhe kallëzuesi

1. jam, emër, mbiemër, përemër, numëror
2. kryefjalët: barinjtë, Muji ynë, ata , ata;
kallëzuesit: shikojnë, qenka bërë, ikën, qeshi, u nis t'i a çojë.
3. malësor (emër), dy (numëror), i mençur, i matur, i duruar (mbiemra), i mençur (mbiemër), njeri (emër).
4. janë varrosur (kallëzues foljor); kalbet (kallëzues foljor); do të bjerë (kallëzues foljor); shembet (kallëzues foljor); është më e ëmbël (kallëzues emëror).
- 5.

kallëzuesi	kallëzuesi foljor		kallëzuesi emëror jam +			
	një folje	dy folje	emër	mbiemër	përemër	numëror
1. hyri	+					
2. kishin filluar		+				
3. filluan të merreshin		+				
4. është kënaqësi			+			
5. ishte i ftohtë				+		
6. janë për ne					+	
7. ishin pesë						+

Test për kontrollin e njohurive (kapitujt 4-5)

1. i, i tha, unë , ty, i, ty, ta, m' i, të
2. 1. ato (liqenet); 2. ata (punëtorët); 3. tyre (kodrinave); 4. ajo (rruga), atë (rrugën).

3.

përemri vetor	rasa
atë	kallëzore
ai	emërore
ti	emërore
mua	kallëzore
ti	emërore
mua	kallëzore
unë	emërore
ti	emërore
i	kallëzore
ty	kallëzore

4.

- Goni, çfarë dëshiron të bëj që të pajtohemi?

Ai kthen kurrizin mënjanë dhe bën sikur nuk e dëgjon, dhe nuk i flet.

- Do të të them një vjershë?

- Jo.

- Do të të këndoj një këngë? Hë, si thua, të këndoj?

Unë i dal Gonit përpara. Dua që ai të mos më mbajë inat.

- Cilën këngë do, Goni? Fol.

Goni më në fund buzëqesh. Kaq dua unë. Pastaj i hidhem në qafë dhe e përqafoj.

5.

- Mbylleni çantën.

- Hapeni çantën.

- Merreni çantën.

- Hapini krahët.

Ose

I hapni krahët

- Mbyllini sytë.

I mbyllni sytë

- Shujini dritat.

I shujni dritat

6.

Tushi i Pinës, një mësues i ri dhe patriot, babanë e gjuhës shqipe

7.

emri	përcaktori	kategoria gramatikore e përcaktorit
nxënësi	i Kristoforidhit	emër
Tushi	i Pinës	emër
mësues	i ri	mbiemër
mësues	patriot	mbiemër
përsëndetjen	e fundit	emër
male	të Shqipërisë	emër
Konstantin	Kristoforidhin	mbiemër
babanë	e gjuhës (shqipe)	emër

8.

1. Vite e vite ai i kishte dalë zot truallit të parëve, ia kishte mbrojtur nderin.

2. Por trimi ynë kishte marrë nëntë plagë në shtat dhe tani kishte nëntë vjet që dergjej në kullë.

3. Atë e kishin harruar të gjithë dhe e kishin lënë në dorë të fatit.
4. Nuk e kishte harruar vetëm e motra, që i rrinte natë e ditë mbi krye... .

9.

- 1) Mësuesja tha: “Sot do të flasim për veprën e Migjenit.”
2) “Sot do të flasim për veprën e Migjenit,” -tha mësuesja
3) “Sot, -tha mësuesja,-do të flasim për veprën e Migjenit.”

10.

1. Ajo tha se Fishta ishte shkrimtari i saj i preferuar.
2. Dritani iu përgjigj se Genci nuk do t’i linte në baltë.
3. Shkrimtari e pyeti vajzën se në cilën shkollë ishte.

11.

- 1) Nëna i bërtiste që nga oborri: “Shpejt, shpejt!”
2) “Sa shokë do të vijnë?” - e pyeti nëna.
4. “Sa qenke rritur, mor bir!” - i thoshte gjyshja me lot në sy.
5) “Njeriu, - thoshte im atë, - mbahet mend për të mirë ose për të keq në jetë. Në ke punuar me djersë të ballit, vdis i qetë. Në ke rrojtur ndryshe, harrohesh.”

12.

fjalitë	lloji
Shqipërinë e mori turku, /i vu zjarr.//	dëftore
Shqipëtar mos rri, /po duku,/shqiptar!//	nxitëse
Mjaft punove për të tjerë, /o fatkeq!//	dëshirore
Kujto vendin tek ke lerë /dhe tek heq.//	nxitës
Pesëqind vjet kemi rruar /me pahir,//	dëftore
lidhur nga këmbë e duar /me zinxhir!...//	
Myslimanë e të krishterë /jemi keq!//	dëftore
Të ngrihemi që të tërë /djem e pleq!//	dëshirore

13.

fjalitë	lloji
1. Pse qan, moj motër?	pyetës
2. Pse ma thyen kaq fort zemrën?	pyetëse
3. Shtati im ka nëntë vjet që po kalbet së gjalli!	dëftore-thirrmore
4. Në këta nëntë vjet, Gjergji yt s’ka pasur kurrë pushim...	dëftore
5. Mos vallë nuk ke pasur për të ngrënë e për të pirë në këta nëntë vjet?!	pyetëse-thirrmore
6. Mos vallë s’të ka mbajtur ty vëllai me të veshur e të mbathur?	pyetëse-thirrmore
7. Mos vallë të ka rënduar ndonjëherë me fjalë?!	pyetëse-thirrmore
8. Apo t’u mërzi vëllai e të ka lindur dëshira të martohesh e ta braktisësh?	pyetëse

14.

- tundet (kallëzues foljor);
pritet (kallëzues foljor);
është ves (kallëzues emëror);
ka (kallëzues foljor);
je ti? (kallëzues emëror);

zbukuron (kallëzues foljor);
 bën (kallëzues foljor);
 është muaji (kallëzues emëror);
 të jeni të bashkuar (kallëzues emëror).

15.

kallëzuesi emëror	pjesa emërore e kallëzuesit
është ves	emër
je ti	përemër
është muaji	emër
të jeni të bashkuar	mbiemër

19. Lajmërimi

1.

a) personal; b) publik; c) lajmërim.

2.

A.

Shoqata Kulturore “Gruaja shqiptare”; grave nga të gjitha trevat shqiptare të Malit të Zi Panairi i punimeve të ndryshme artizanale; nga data 28 shtator deri më datën 10 tetor 2006; në Tuz

B.

a) ; b) ; c) lajmërim; ç) .

C.

Lajmërim; në Panairin që do të organizohet nga data 28 shtator deri më datën 10 tetor 2006; në Tuz; Të interesuarat të paraqiten në adresën: Shoqata Kulturore “Gruaja shqiptare”.

Ç.

LAJMËRIM

Shoqata Kulturore “Gruaja shqiptare” do të organizojë nga data 28 shtator deri më datën 10 tetor 2006 në Tuz, Panairin e punimeve artizanale. Ftoheni të paraqitni punimet tuaja.

Adresa: Shoqata Kulturore “Gruaja shqiptare”, Tuz

3. A) a) zyrtar; b) .

B) Lajmërimi bëhet nga një institucion zyrtar.

C) a) ; b) jo zyrtar.

Ç) Lajmërimi bëhet nga një person jozyrtar.

4. A. a) Zyra e strehimit, Podgoricë; b) Zotin Ndreca; c) që ka vënë në dispozicion të tij dy dhoma e një kuzhinë; ç) që të vijë sa më shpejt për të tërhequr dokumentet përkatëse; d) në Podgoricë; dh) për arsye se ka vendosur Zyra e strehimit e Podgoricës.

B. a) ; b) personal.

- 72** **5. A.** a) për ndeshjen e futbollit ndërmjet “Partizanit” të Tiranës dhe “Buduqnostit” të Podgoricës; b) të dielën me 12 shtator, ora 14⁰⁰; c) në stadiumin e Podgoricës; ç) për kupën e vendeve ballkanike.

B. a); b) publik.

20. Rrethanori

1. a); b); d); c) foljen.

2. kur?; ku?; i shkakut; i qëllimit; i mënyrës; i sasisë.

3.

lloji i rrethanorit	pyetja					
	ku?	kur?	sa?	përse?	si?	pse?
vendi	3, 5					
kohe		2, 4				
sasie			6			
qëllimi						
mënyre					7	
shkaku						1

4.

rrethanori	lloji i rrethanorit
para katër ditësh	kohe
në të çarat e mureve	vendi
në bedena	vendi
brenda kështjellës	vendi
menjëherë	mënyre
duke punuar	mënyre
ditë e natë	kohe
kudo nëpër kështjellë	vendi
ditë e natë	kohe

5.

numri	rrethanor
1	mënyre
2	kohe
3	vendi
4	qëllimi
5	mënyre
6	sasie
7	mënyre
8	vendi
9	mënyre
10	vendi
11	vendi
12	mënyre

6.


numri	rrethanor
1	sasie
2	kohe
3	vendi
4	mënyre
5	kohe
6	vendi
7	mënyre
8	kohe

21. Emërorja

1.

kush?, cili?

2.



3.

emri	rasa
1. zë	emërore
2. zëri	emërore
3. zonjë	emërore
4. shtëpia	emërore
5. grua	emërore

4.

emri	funksioni
1.(një) zë	kryefjalë
2. zëri	pjesë e kallëzuesit emëror
3. zonjë	thirror
4. (nga) shtëpia	rrethnor vendi
5. (një) grua (e moshuar)	ndajshtim i veçuar

5.

rasa emërore pa parafjalë	funksionet
+	kryefjalë
	rrethnor
+	pjesë emërore e kallëzuesit
	përcaktor
+	ndajshtim
+	thirror

6.

emrat në rasën emërore	funksioni
1. dera	kryefjalë
2. (një) luftëtar	kryefjalë
3. Vojsava	kryefjalë
4. i shoqi	pjesë e kallëzuesit emëror
5. Gjoni	ndajshtim
6. Skënderbeu	pjesë e kallëzuesit emëror
7. biri (i saj)	ndajshtim

7. vend; vend; vend; shkak; kohë; sasi; vend; vend.

22. Lajmërimi i vogël

1. lajmërim i vogël.

3. Ulqin, jap me qira një apartament;
 Lloji i njoftimit. : dhënie me qira;
 Shteti.....: Mali i Zi;
 Qyteti.....: Ulqin, Shtoj.

Apartament me qira në qendër të Shtojit, 500 m larg plazhit Kopakabana. Ka parking. Apartamenti është i ri. Dëshira jonë është që ju të jeni të kënaqur.

Tel. : 0038185405036


Fax. : 0038185405037

Cel. : 0038169469363

23. Gjinorja

1. i kujt?, i cilit?

2.



3.

Emri në gjinore	kuptimi
Shtëpia e <u>vëllait</u> në Budva jepet me qira.	përkatësi
Buka e <u>grurit</u> kur është e zezë është më e mirë.	lloj
Sivjet ka filluar shpejt vjelja e <u>rrushit</u> .	pësuesin
Britmat e <u>kafshëve</u> i trembën fëmijët.	vepruesin
Shumica e <u>parlamentarëve</u> votuan kundër.	tërësinë nga hiqet një pjesë
Qyteti i lashtë i <u>Dubrovnikut</u> është shumë i bukur.	emërtim

4.

i satelitit, të Tokës shënoi, të shpikjeve, të zbulimeve, i kërkimeve, e njerëzve, të planetëve, të yjeve, i satelitit, e kryerjes, së eksperimenteve

5. 1. të shtratit (përkatësi); 2. e rumit (lloj); 3. e gotës, të gjuhës (përkatësi, tërësinë nga hiqet një pjesë); 4. e batanijes (përkatësi).

24. Kallëzorja

1. kë?, cilin?, çfarë?

2. objektin e veprimit; kohë; sasi.

3. vend, mjet; shoqërim; objektin e bisedës.

4.

kallëzore pa parafjalë	kallëzore me parafjalë
njerëzit	për gjarpërinj
trupin	për bolla
kokën	për një bollë
trupin	me flokë
zemrën	në livadhin
	nën sqetullën
	nën sqetull
	mbi zemër

25. Kundrinori i drejtë

1. a) foljes; b) kë?, cilin?, çfarë?; c) emër, përemër, në rasën kallëzore.

2.

emri	rasa	kundrinor i drejtë
(një) bostanxhi	kallëzore	
(një) pus	kallëzore	+
ujë	kallëzore	+
zarzavatet	kallëzore	+
dollap	kallëzore	
(disa) kova	kallëzore	
ujë	kallëzore	
fund	kallëzore	
grykë	kallëzore	

3.

emri	rasa	kundrinori i drejtë
(një) gomar	kallëzore	
ujë	kallëzore	kundrinor i drejtë
gomar	kallëzore	kundrinor i drejtë
boshtin	kallëzore	
kokën	kallëzore	kundrinor i drejtë
thes	kallëzore	
sytë	kallëzore	kundrinor i drejtë
qafë	kallëzore	
këmborë	kallëzore	kundrinor i drejtë
thupër	kallëzore	
punën	kallëzore	kundrinor i drejtë
qoshe	kallëzore	
qepët	kallëzore	kundrinor i drejtë
preshtë	kallëzore	kundrinor i drejtë
kungujt	kallëzore	kundrinor i drejtë
kastravecët	kallëzore	kundrinor i drejtë

- 76 4. atdhenë (kundrinor i drejtë); për nesër (rrethanor kohe); shikoji (kallëzues foljor); në tokë (rrethanor vendi); qimen (kundrinor i drejtë); gënjeshtër (kryefjalë).

26. Tregimi

1. a) Ishte dimër... ; b) Një ditë Kaçja ... ; c) Kur erdhi
2. a) ; b) për veprimin e Kaçës dhe reagimin e zogut; c) për qëndrimin e babait ndaj veprimit të Kaçës.
3. a) ; b) tregon për Kaçen dhe zogun; c) .
4. a) ; b) tregim; c) .
5. A. a) përshkruan traktorin; b) ; c) .
B. a) ; b) ; c) përshkrim.

27. Dhanorja

1. a) dhanore; b) kujt?, cilit?
2. zjarrit, nënës, nënës, sëmundjes.
3. nënës, djalit, gjarprit, gjarprit, gjyshes.
4. a) detyrave (tregon sendin që përjeton (pëson) diçka);
b) shoqeve (tregon sendin të cilit i drejtohet diçka);
c) shoqes (tregon sendin të cilit i drejtohet diçka).
5. derës (tregon sendin që përjeton, pëson diçka); lypësit (tregon sendin të cilit i drejtohet diçka).

28. Rrjedhorja

1. prej kujt?, prej cilit?
2. dimri, bore, ushtarësh, fshati.
3. maleve (vend); dimrit (kohë); vapës (shkak); ankthi (cilësi); telefonatash (lloj).
4. prej druri (lëndë); prej fajtori (tipar);
prej shokëve (tërësi nga e cila kemi hequr një pjesë); prej vitesh.(kohë)
- 5.

rrjedhore pa parafjalë	rrjedhore me parafjalë
zogjsh	prej maleve
drite	ndaj së bukurës
	pas një viti
	për fyti
	sipas projektit

29. Kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë

1. a) i foljes; b) kallëzore, kujt?, cilit?

2.

emri	rasa	kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë
nxënësit	dhanore	+
mësuesin	kallëzore	
ziles	dhanore	+
mësuesit	dhanore	+
gojë	kallëzore	
orën	kallëzore	
nxënësve	nxënësve	+

3.

emri	rasa	kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë
motrës	dhanore	+
vëllait	dhanore	+
fëmijëve	dhanore	+
nënës	dhanore	+
shokëve	dhanore	+
shoqeve	dhanore	+

4. motrës (kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë); nënës (kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë); violinës (kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë); plepat (kundrinor i drejtë); libër (kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë).

5. A. a) ; b) kundrinor; c) .

B. a) ; b) kundrinor; c) .

30. Kundrinori i zhdrejtë me parafjalë

1. a) emërore, kallëzore, rrjedhore; b) e foljes, parafjalë.

2.

emri	rasa	funksioni
rrapin	kallëzore	kundrinor i drejtë
pishave	dhanore	kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë
(për) gjënë (e gjallë)	kallëzore	kundrinor i zhdrejtë me parafjalë
sytë	kallëzore	kundrinor i drejtë
retë	kallëzore	kundrinor i drejtë
diellin	kallëzore	kundrinor i drejtë
(me) petk	kallëzore	kundrinor i zhdrejtë me parafjalë

3.

kundrinori i zhdrejtë me parafjalë
me pëllëmbë
me pluhurin
me tymin
me zemrën
me trimërinë
me shëmbëlltyrën

kundrinori i zhdrejtë me parafjalë	parafjala	rasa
kundër përbindëshit	kundër	rrjedhore
me topuz	me	kallëzore
me shpatë	me	kallëzore
kundër dhunuesve	kundër	rrjedhore
me ujët	me	kallëzore
me lotët	me	kallëzore
me flokët	me	kallëzore

5. A. a) ; b) kundrinor; c) .
B. 1) me emër; 2) me përemër:

Test për kontrollin e njohurive (kapitujve 6-8)

1. A. a) zyrtar; b) .
B. bëhet nga një institucion zyrtar.
3. A. lajmërim i shkurtër.
B. a) i shkurtër; b) jo; c) jo; d) jo.
C. Lëshoj me qira një shtëpi. Ajo ndodhet në Ulqin, 100m. larg Shkollës Artistike. Është e mobiluar.
Tel. : 081*** **

4.

rrethanori	lloji i rrethanorit
sot	kohe
mirë	mënyre
nga frika	shkaku
nesër	kohe
për një urim	qëllimi
në stacion	vendi
në stacion	vendi
ora shtatë	kohe

5.

emrat në rasën emërore	funksioni
1. një burrë	kryefjalë
2. doktori	pjesë e kallëzuesit emëror
3. doktor	ndajshim
4. Luka	kryefjalë
5. doktor	thirrur
6. shtëpia	rrethanor

6. i Podgoricës (emërtimin e një sendi); e qytetit (përkatësi); e mendimit (lloj); i librave (pësuesin),
7. telegram (objekt); euro (sasi); bregdet (vend); verën (kohë).
8. zogjsh (përkatësi); pranvere (lloj); ore (të tërën nga e cila është hequr një pjesë); vitesh (kohë).
9. a) sende mbi të cilat bie veprimi i foljes;
b) tregon personin a sendin të cilit i drejtohet veprimi i foljes;
c) plotëson më mirë kuptimin e foljes, po nuk është plotës kryesor.

10.

kundrinori	lloji i kundrinorit
Benit	kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë
me shkrim	kundrinor i zhdrejtë me parafjalë
për macen	kundrinor i zhdrejtë me parafjalë
detyrës	kundrinor i zhdrejtë pa parafjalë
për (të njëjtën) mace	kundrinor i zhdrejtë me parafjalë

Test

Kontrollo çfarë ke mësuar

1. a) lajmërim i vogël publik; b) lajmërim i vogël privat.

2.

Reklama: 2, 5	1. përmban pyetje të cilave u përgjigjen shumë njerëz 2. bëhet për të tërhequr vëmendjen e konsumatorëve
Anketa: 1, 4	3. është një fletë a shpallje e vogël me të cilin njoftojmë publikun për diçka që kemi humbur ose gjetur, për diçka që duam të blejmë ose të shesim
Lajmërimi: 6	4. paraqitja e rezultateve mund të bëhet me tekst, me tabela ose grafikë 5. është rekomandim, theksim i cilësive të mira të mallit, të prodhimit, të shërbimeve etj.
Lajmërimi i vogël: 3, 7	6. është zyrtar, jozyrtar, publik dhe privat 7. duhet të jetë i shkurtër, i qartë dhe i saktë

3. a) ; b) ; c) përdorimi i gjuhës.

4. Përshkrimi paraqet pamjen ose tiparet e dikujt a të diçkaje, rrethanat e zhvillimit të një ngjarjeje.

Tregimi paraqet ngjarje nga jeta e një personazhi, nga jeta e një familjeje ose e një populli.

5.

fjala	sinonime	antonime
gëzim	lumturi	hidhërim
i shkathët	i hedhur, i lëvizshëm	i ngathët
lart	sipër	poshtë

6. A. një, me, një, që, në, dhe, në, me, nga, dhe, më, me, në, në, me, me, nga .

B. **emra:** lahuta, vegël, tel, Shqipërinë e Veriut, Mal të Zi, lahutë, këngët, e kreshnikëve, trupi, kasa, e drurit, kasës, lëkura, lëkurë, keci, Punimet, të kokës, së lahutës, kokë, dhe, koka, e dhisë, bishtin, e lahutës, mënyrë, heroin, Skënderbeun, hark, qime, harku, i lahutës, degët, e drurit, të thanës;

mbiemra: popullore, mbështjellëse, më të zakonshme, simbolike, kombëtar, të përkulur;

përemra: i saj, e cila, tonë;

numërorë:

folje: është , përdoret, këndohen, përbëhet, janë, paraqet, luhet, ndërtohet.

- 7. kryefjalë:** lahuta, këngët, trupi, ndërtimet, koka, harku;
kallëzues emëror: është një vegël, është lëkurë;
kallëzues foljor: përdoret, këndohen, përbëhet, kanë, paraqet, luhet, ndërtohet;
përcaktor: popullore, me një tel, e kreshnikëve, i saj, e drurit, mbështjellëse e kasës, keci, më të zakonshme të kokës së lahutës, dhie, e dhisë, e lahutës, tonë kombëtar, me qime të përkulur, i lahutës, e drurit të thanës;
ndajshtim:
kundrinor: me lahutë, nga kasa, nga lëkura, një kokë, heroin, Skënderbeun, me hark, nga degët;
rrethanasor: në Shqipërinë e Veriut, në Mal të Zi, në bishtin
- 8. A.** 1. Lahuta është një vegël popullore me një tel që përdoret në Shqipërinë e Veriut dhe në Mal të Zi.
 2. Trupi i saj përbëhet nga kasa e drurit dhe nga lëkura mbështjellëse e kasës e cila është lëkurë keci.
- B.** fjalë të thjeshta: *lahutë, tel, kokë;*
 fjalë të prejardhura: *popullore, përdor, kryesisht, këndoj, zakonisht;*
 fjalë të përbëra: *telekomandë, kokëshkretë.*

9.

fjala	kategoria gramatikore	rasa	gjinia	numri
ai	përemër vektor	emërore	mashkullore	njëjës
(një) vajzë	emër	emërore	femërore	njëjës
flokë	emër	kallëzore	mashkullore	shumës
të gjata	mbiemër	kallëzore	mashkullore	shumës
fjongo	emër	kallëzore	femërore	njëjës
të bardhë	mbiemër	kallëzore	femërore	njëjës
kokë	emër	kallëzore	femërore	njëjës
atë	përemër vektor	kallëzore	femërore	njëjës
djem	emër	emërore	mashkullore	shumës
Zefi	emër	emërore	mashkullore	njëjës
ata	përemër vektor	emërore	mashkullore	shumës
shtëpinë	emër	kallëzore	femërore	njëjës
e re	mbiemër	kallëzore	femërore	njëjës
shkollën	emër	kallëzore	femërore	njëjës
ai	përemër vektor	emërore	mashkullore	njëjës
(një) frymë	emër	kallëzore	femërore	njëjës

10.

Teatri Popullor i Tiranës paraqiti në Teatrin popullor të Malit të Zi pjesën teatrale "Pjata e drunjtë" të autorit E. Morris.

Shfaqja u organizua nga në Podgoricë. Ishin të pranishëm përfaqësues të shtresave të ndryshme të popullit shqiptar në Malin e Zi, si edhe dashamirës të teatrit nga popujt e tjerë.

Tema e shfaqjes ishte konflikti mes resë dhe vjehrrit. Nusja dëshironte pavarësi nga plakuri. Arsyeja e vërtetë e konfliktit ishte situata ekonomike në familje, si edhe stërlodhja e resë për shkak të shërbimeve që ishte e detyruar t'i bënte plakut.

Të gjitha këto skena, që shkaktuan edhe lot, artistët shqiptarë i paraqitën në mënyrë të përsosur.